

## Komente&Analiza nga:

Tony Blair  
Dominique Moisi  
George Soros  
Jacques Attali

Timothy Garton Ash  
Joschka Fischer  
Daniel Gros  
Paul Krugman etj



# Ku po shkon EUROPA?



*Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve*

## Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

The image shows two website screenshots. The top screenshot is the ASP (Akademia e Studimeve Politike) website. It features a header with the ASP logo and navigation links: KREJU, RRETH ASP, PROGRAMET, EVENTE, PUBLIKIME, RRJETI I SHKOLLAVE, KENDI ALLUMNI, and DONATORE. The main content area includes a large photo of a conference, a section titled 'TE REJAT E FUNDIT' (Latest News) with a sub-header 'Diplomohet gjenerata e shkolles politike 2013-2014', and a sidebar with links to 'Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike', 'Programi per te zgjedhurit vendore', 'Edukimi i votuesve per here te pare', and 'IPA-CBC: Dialogu publik per energjine'. The bottom of the ASP site shows social media icons for Facebook, Twitter, and YouTube.

The bottom screenshot is the Bota.al website. It features a large 'bota.al' logo with a globe icon and the date 'Friday, June 20, 2014'. Below the logo is a navigation bar with links: HOME, BOTA, EKONOMI, TEKNOLOGJI, HISTORI, SHKENCE, KULTURE, DOSSIER, and SPORT. The main content area includes a large photo of Jürgen Habermas with the headline 'INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik'. To the right of the photo is a text box with a quote from Habermas. Below the photo is a date 'June 19, 2014'. To the right of the main content is a sidebar with a red background and white text, including the text 'BOTIMESHQIP.COM' and 'Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.' and 'Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.'.

*Kontaktet:  
Akademia e Studimeve Politike  
Adresa:  
Qendra Kotoni,  
Rr.Donika Kastrioti,  
Nr.3,  
Kati 4, Zyra 2,  
Tirane, Shqiperi  
Tel: +355 4 227 2173,  
Tel: +355 4 450 4788  
E-mail: info@asp.al  
Web: www.asp.al  
dhe www.bota.al*

*Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj*



# Një buletin i ri i mendimit botëror

**K**y botim i Akademisë së Studimeve Politike synon që të sjellë në gjuhën shqipe një përzgjedhje të artikujve dhe analizave elitare të mendimit botëror. Çdo muaj, buletini do të trajtojë një çështje apo zhvillim kryesor të rëndësishëm global, parë në optikën vizionare të liderëve politikëbërës dhe mendimtarëve më të njohur të momentit. Nëpërmjet kësaj përqsasjeje të re ndaj ideve dhe argumentimeve prestigjioze, synohet që të nxitet një thellim i mëtejshëm i informimit dhe analizimit të ngjarjeve të aktualitetit politik dhe social mbarëbotëror.

*Duke kuptuar më mirë dhe shqyrtuar në këndvështrime të ndryshme këto zhvillime dhe procese botërore, shpresojmë se do të inkurajojmë një vizion dhe qëndrim më të thelluar të lexuesve vendas, njëherazi një shoqëri më mendjehapur dhe aktive ndaj zhvillimeve negative kombëtare. Pikërisht, këtu fokusohet edhe misioni i Akademisë së Studimeve Politike për forcimin e një kulture moderne politike bazuar në vlerat e përbashkëta të pluralizmit, tolerancës dhe dialogut të hapur.*

*Buletini i përmuajshëm elektronik u drejtohet së pari të gjitha alumnëve dhe pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, por besojmë se do t'i shërbejë rritjes së njohurive të publikut të gjerë në mbarë trevat shqipfolëse.*

*Me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të debatit mbi temat e trajtuara në këtë buletin, në cdo numër pasardhës do të botojmë në një rubrikë të caktuar mendimet dhe komentet tuaja mbi idetë e hedhura nga autorët e huaj. Komentet tuaja për botim mund të na i dërgoni në adresën [info@asp.al](mailto:info@asp.al)*



# Banaliteti i zemërimit

ROGER COHEN

---

**K**riza e modernitetit nuk ndihet askund më fort se sa në Francë, ku tashmë një qerq shekulli globalizim ka sjellë zyrtësi dhe mosbesim në një shkallë epike. Në ankth prej kapitalizmit, e parehatuar me fleksibilitetin, e pabindur nga i ashtuquajtimi model anglo-sakson, Franca është tërhequr në mllëfin e vet. Imigrantët dhe hapja, për francezët kanë qenë më shumë rreziqe se sa shanse.

Edhe kuzhina e saj e lavdishme duket tashmë disi e palëvizshme, shumë e rëndë për kohën e vet, e paafte të përshtatet. I mungon kreativiteti spanjoll, është e kyçur në të kaluarën. Verërave e saj, më të mirat në botë pa asnjë diskutim, u ka munguar narrativa, ingredientit thelbësor i marketimit modern. Kompanitë e saj private të klasit botëror vihen përfund prej valës së pretendimeve të pafund të funksionarëve shtetërorë. Presidenti i saj, dikur mishërimi mbretëror i lavdisë franceze, sot është një figurë e rëndomtë, që lufton banalen.

Rien ne va plus, thonë francezët, ose asgjë nuk funksionon më. Por ky përkthim është anemik, i zhveshur nga kuptimi i thellë idhnak që ka



në gjuhën e galëve dhe që është shprehja e ndjesisë së çuditshme të humbjes. Sigurisht që nuk është e vërtetë. Shumë gjëra funksionojnë shumë mirë në Francë. Por ky vend është zhytur në pesimizëm. Gota është gjithmonë gjysmë bosh.

Një vrer i tillë duhet të gjejë patjetër shprehje politike. Dhe e ka gjetur tek Fronti Nacional i ekstremit të djathtë që udhëhiqet nga Marine Le Pen, fituese në zgjedhjet për Parlamentin Europian, e cila e ka hedhur tashmë vështrimin drejt një tjetër vendi: Pallatit presidencial.

Ajo mundet që të bëhet presidente. Fronti Nacional është shfaqur edhe më parë, sidomos në 2002, kur babai i saj Jean-Marie Le Pen mbërriti deri në balotazh në zgjedhjet presidenciale. Por në 12 vitet që kanë kaluar që atëherë, krizat europiane dhe franceze janë thelluar. Franca ka një rritje ekonomike pothuajse zero dhe një papunësi që rritet. Me afro 25 % të votave, Fronti Nacional la pas socialistët që po qeverisin me 14% dhe Unionin për një Lëvizje Popullore të qendrës së djathtë me 20.8%.

“Një tërmet”, ishte verdikti i kryeministrit socialist, Manuel Valls. Dhe nuk gabohet. Sistemi dypartiak është shndërruar tashmë në një sistem tripartiak. Marine Le Pen, më e butë, më e zgjuar dhe më ambicioze se i ati, është e zgjedhshme. Ajo është e kualifikueshme për presidente.

Ndërkohë, në kontinent zemërimi ndaj fitores së Frontit Nacional ishte i dukshëm (nuk ka zgjedhje më të përshtatshme për të shfryrë zemërimin se sa ato europiane, për arsye se pushteti i vërtetë i Parlamentit Europian është i kufizuar). Në Britani, Austri dhe Danimarkë, më shumë se 15 % e votave shkoi gjithashtu tek lëvizjet politike anti imigrantëve, anti Europës, anti establishmentit, anti mërziisë. Por, ka ndodhur pikërisht në Francë, e cila bashkë me Gjermaninë përbëjnë bërthamën e Bashkimit Europian, që një krizë ekonomike dhe psikologjike ka marrë formën më akute.

Sipas të përditshmes franceze Le Monde, Fronti Nacional mori 43% të votave të punëtorëve dhe 37 përqind të votave të të papunëve. Ndjenja popullore në Francë është kthyer kundër Europës, të cilën e shohin si të lidhur me masat e kursimit, stanjacionin, papunësinë dhe imigrimin e madh. Premtimi i Le Penit për një Francë më nacionaliste dhe më kundër imigrantëve, që refuzon integrimin europian dhe Amerikën, ka joshur të pakënaqurit. Një bosht i premtuar Paris-Berlin-Moskë, me Putinin dhe “vlerat e tij të familjes” si shpëtimin e Europës, maskon një boshllëk idesh ekonomike.

Kriza në Francë shkon shumë më thellë se sa sfidat e saj ekonomike. Për një komb të mundur në Luftën e Dytë Botërore, por që nëpërmjet Gjeneralit De Gaulle iu lejua të shpallë në një farë mënyre fitoren nën hijen e Aleatëve, Bashkimi Europian ishte mënyra më e mirë për të dalë nga një poshtërim i çuditshëm. (Ishte gjithashtu shpëtim për Gjermaninë, por kjo është tjetër histori). Europa ishte një ide e guximshme, një kundërpeshë ndaj Shteteve të Bashkuara, një mjet për një formë të re ambicije kombëtare, e cila që në gjenezë ishte “shumë franceze”. Një fuqi e mesme, që kishte pësuar rënie të madhe, Franca mund të ëndërronte sërish përmes Europës. Mund të jepte mendimin e saj. Madje, mund të ndryshonte botën.

Por më pas ndodhi surpriza e madhe, rënia e Murit të Berlinit dhe fundi i Luftës së Ftohtë. Franca preferonte dy Gjermani. Krejt papri-

*Rien ne va plus, thonë francezët, ose asgjë nuk funksionon më. Por ky përkthim është anemik, i zhveshur nga kuptimi i thellë idhnak që ka në gjuhën e galëve dhe që është shprehja e ndjesisë së çuditshme të humbjes. Sigurisht që nuk është e vërtetë. Shumë gjëra funksionojnë shumë mirë në Francë. Por ky vend është zhytur në pesimizëm. Gota është gjithmonë gjysmë bosh*

tur pati vetëm një të tillë. Donte të ishte e sigurtë për zotimin e një Gjermanie të bashkuar ndaj Europës dhe monedha e përbashkët dukej garancia më e sigurtë. Krejt papritur, u gjend e lidhur me Euron, pikërisht në një moment kur vrulli drejt një integrimi më të madh politik europian avulloi. Ajo donte të ishte një kundërpeshë ndaj Uashingtonit. Krejt papritur, kjo ambicie po dukej qesharake. Donte që të paktën të ofronte një kundërmodel ndaj hiperkapitalizmit. Jo kaq papritur, sistemi i saj ekonomik, pavarësisht gjithë të mirave, thjeshtë dukej i lodhur, ashtu si ata fshatrat francezë që u ka ikur rinia dhe gjallëria.

Historia mund të luajë lojëra mizore. Në këtë çerekshkullin e fundit i ka luajtur disa të tilla Francës. Sigurisht, Marine Le Pen nuk mundet të kthejë kohën mbrapa. Por kjo nuk do i pengojë njerëzit e zemëruar që të ëndërrojnë. Ndoshta Franca do të fitojë Kupën e Botës dhe gjithçka do të shkojë mirë për pak kohë. Por edhe kjo është, padyshim, thjeshtë një ëndërr. (New York Times)

---



# Vlera e gjeografisë, apo gjeografia e vlerave në Europë?

DOMINIQUE MOISI

---

**E** gjendur përballë rikthimit të Rusisë në traditën e saj imperiale, si dhe metodave e refleksive të të kaluarës së saj sovjetike, si duhet të përgjigjet Europa? A duhet t'i japë prioritet “vlerës së gjeografisë”, apo “gjeografisë së vlerave”?

Ata që mbështesin të parën e bëjnë në emër të “realizmit energjetik” kohëshkurtër, duke argumentuar se është jetike arritja e një marrëveshjeje me Rusinë, sepse Europës i mungojnë gazi dhe nafta që Amerika i ka me bollëk. Sipas këtij arsytimi, SHBA mund të jetojë pa Rusinë, ndërsa Euroa nuk mundet.

Veç kësaj, për realistët sjellja mospërfillëse e Amerikës ndaj aleatëve të saj më të vjetër dhe më besnikë – që u reflektua në skandalet e fundit të survejimit të NSA – ka diskredituar vetë idenë e një “komuniteti vlerash”. Nëse Amerika nuk i respekton më vlerat që po vetë i shpall, përse duhet që Bashkimi European të humbasë dashamirësinë e Kremlinit, në emër të këtyre vlerave?

Këta realistë argumentojnë gjithashtu se duke njëjtësuar pozicionet e Europës me ata të NATO-s, Europa ka zgjedhur në mënyrë të nxituar që të poshtërojë Rusinë – një kurs veprimi i padobishëm dhe i rrezikshëm. Ka ardhur koha, thonë ata, për një politikë që ripajton arsyeimin e shëndoshë historik dhe gjeografik, me nevojën për energji. E ardhmja e Europës është e lidhur pazgjidhshmërisht me atë të Rusisë, ndërkohë që Amerika i ka kthyer krahët Europës, krejt e painteresuar, në mos e zhgënjyer. Përkujtimi i një të kujtuare të lavdishme – përvjetori i 70 i Ditës së Zbarkimit në Normandi – nuk mund ta fshehë të tashmen: Ndonëse Europa mund të përpiqet të diversifikojë burimet e saj të energjisë, këtë nuk mund ta bëjë pa Rusinë, të paktën në të ardhmen e afërt.

Përse, pyesin realistët, duhet që dikush të vdesë për ukrainasit, të cilët janë më të korruptuar dhe më pak të qytetëruar se edhe vetë rusët? Ukraina e pati shansin e saj si një shtet i pavarur dhe dështoi, duke qenë viktimë e korrupsionit të elitave të saj. Është koha të mbyllet këto “kllapa” të palumtura.

Ky këndvështrim nuk është teorik. Mund të gjendet, i maskuar në mënyra të ndryshme, në të gjithë BE-në, majtas dhe djathtas, dhe në të gjithë profesionet. Perceptimi i një rënieje relative të SHBA dhe thellimi i humbjes së vetëbesimit të BE-së tek vlerat dhe modeli i saj, duket se legjitimojnë një qëndrim i cili në shumë raste është ngritur mbi rrënojat e antiamerikanizmit të dikurshëm.

Rruga tjetër, e cila e vë theksin në gjeografinë e vlerave, ishte ajo që u zgjodh prej etërve themelues të projektit europian dhe NATO-s. Sipas këtij pikëvështrimi, mospranimi i projekteve imperialë të Putinit do të rriste rrezikun që Europa të binte në një varësi të dëmshme.

Për Europën, dëgjimi i sirenës që vjen nga Lindja – një melodi e pajtueshmërisë mes fuqisë strategjike të Rusisë dhe fuqisë ekonomike të Europës – do të ishte njësoj si të paguante Mafian për mbrojtje. Si do të mundej që një klub demokracish të ishin tërësisht të varura për sigurinë e tyre nga një fuqi autoritare e cila shfaq hapur dëshirën që ata të kenë sisteme të dobët politikë?

Nuk është koincidence që ky ligjërime i rusëve kundër demokracisë, imigrantëve dhe homoseksualitetit gjen mbështetje tek partitë më konservatore, ekstremiste dhe nacionaliste të Europës. Në kontrast me këtë, forca dhe tërheqja e modelit të BE varet nga natyra e tij demokratike. Europeanët që kanë pushuar së ëndërruari për Europën, që e marrin për të mirëqenë paqen, ripajtimin dhe mbi të gjitha lirinë, nuk e kuptojnë se çfarë është në lojë.

Përqaftimi i një “raison d’état energjetik” që e lë Europën të varur nga Rusia për një të tretën e burimeve të vet energjetikë do të ishte vetëvrasje. Nuk ka alternativa. Europa mund t’i thotë jo Kremlinit dhe Gazpromit vetëm nëse ka vullnetin ta bëjë këtë.

E vetmja politikë e mundshme që mund të jetë edhe realiste, edhe dinjitoze do të ishte një kombinim i qëndrueshmërisë dhe vendosmërisë për t’i vendosur kufij Rusisë së Putinit. Pikërisht se Amerika nuk është më ajo që ka qenë, aleanca e Europës e bazuar mbi vlerat është më e nevojshme se kurrë.

Janë këto vlera që sollën shembjen e Murit të Berlinit dhe motivuan demonstruesit në Kiev të qëndrojnë në dimrin brutal ukrainas, në



*Për Europën, dëgjimi i sirenës që vjen nga Lindja – një melodi e pajtueshmërisë mes fuqisë strategjike të Rusisë dhe fuqisë ekonomike të Europës – do të ishte njësoj si të paguante Mafian për mbrojtje. Si do të mundej që një klub demokracish të ishin tërësisht të varura për sigurinë e tyre nga një fuqi autoritare e cila shfaq hapur dëshirën që ata të kenë sisteme të dobët politikë?*





sheshin Maidan. Nga Azia në Afrikë, njerëzit duket se e kuptojnë më mirë se sa vetë europianët domethënien e vlerave të Europës. Mjafton t'i dëgjosh tek e çmojnë kontinentin për paqen, pajtimin, e madje edhe barazinë relative (krahasuar me SHBA).

Për BE-në, zgjedhja nuk ka qenë asnjëherë më e qartë. Nëse dëshiron të mbijetojë dhe përparojë, duhet të vendosë gjeografinë e vlerave mbi gjithçka tjetër. (Project Syndicate)

//

*Përse, pyesin realistët, duhet që dikush të vdesë për ukrainasit, të cilët janë më të korruptuar dhe më pak të qytetëruar se edhe vetë rusët? Ukraina e pati shansin e saj si një shtet i pavarur dhe dështoi, duke qenë viktimë e korrupsionit të elitave të saj. Është koha të mbyllen këto “kllapa” të palumtura*

//





# Ukraina, si “litar shpëtimi” për Europën

GEORGE SOROS

**Z**gjedhjet e fundjavës që kaloi, për parlamentin europian dhe ato presidenciale në Ukrainë prodhuan rezultate të kundërt mes tyre. Votuesit e Europës shprehën pakënaqësinë ndaj mënyrës se si funksionon aktualisht Bashkimi European, ndërkohë që votuesit e Ukrainës shprehën dëshirën e tyre për afrim me BE-në. Udhëheqësit dhe qytetarët europianë duhet ta shfrytëzojnë këtë shans, për të menduar se çfarë domethënie ka – dhe duke ndihmuar Ukrainën, mund të ndihmojnë edhe Europën.

BE është konceptuar fillimisht për të qenë një bashkim shtetesh sovranë, të gatshëm që të ofrojnë një pjesë gjithnjë e më të madhe të sovranitetit të tyre për të mirën e përbashkët. Ishte një eksperiment i guximshëm në qeverisjen ndërkombëtare dhe sundimin e ligjit, që synonte të zëvendësonte nacionalizmin dhe përdorimin e forcës.

Fatkeqësisht, kriza e transformoi BE-në në diçka krejt të ndryshme: një marrëdhënie kredidhënësish dhe borxhlinjsh, ku vendet kredidhënës imponojnë kushte që zgjasin dominimin e tyre. Duke parë pjesëmarrjen e ulët në zgjedhjet për parlamentin europian, dhe nëse mbështetja për Kryemi-

nistrin italian, Matteo Renzi do i shtohet votës antiBE në të majtë dhe në të djathtë, mund të argumentohet se shumica e qytetarëve janë kundër gjendjes aktuale.

Ndërkohë, pikërisht kur eksperimenti i guximshëm i Europës në qeverisjen ndërkombëtare po lëkundet, Rusia po shfaqet si një rival i rrezikshëm ndaj BE-së, një që ka ambicie gjeopolitike globale dhe është gati të përdorë forcën. Putini po shfrytëzon një ideologji nacionale etnike (dhe mbështetjen nga Kisha Ortodokse) për të forcuar regjimin e tij. Në fakt, tek fliste për programin e radios ruse “Linja Direkte” muajin që kaloi, ai lëvdoi virtutet gjenetike të popullit rus. Aneksimi i Krimesë e ka bërë shumë popullor brenda vendit të tij, dhe përpjekja e tij për të dobësuar dominimin global të Amerikës, pjesërisht duke kërkuar një aleancë me Kinën, ka gjetur një jehonë të favorshme për të në pjesën tjetër të botës.

Por interesi vetiak i regjimit të Putinit bie ndesh me interesat strategjike të Rusisë. Rusia do të përfitonte më shumë nga bashkëpunimi i ngushtë me SHBA dhe BE. Dhe përdorimi i represionit në Rusi dhe në Ukrainë është një autogol. Ekonomia ruse po dobësohet, pavarësisht çmimit të lartë të naftës, për shkak të largimit të kapitalit dhe talenteve. Përdorimi i dhunës në sheshin Majdan ka shkaktuar lindjen e një Ukraine të re, e cila është e vendosur për të mos u bërë pjesë e Perandorisë Ruse.

Suksesi i Ukrainës së re do të ishte një rrezik ekzistencial për sundimin e Putinit në Rusi. Prandaj ai është përpjekur kaq fort të destabilizojë Ukrainën, duke nxitur republikat e vetëshpallura separatiste në Ukrainën lindore.

Me punëdhënësin më të madh të rajonit të Donbasit që ka mobilizuar protestat kundër separatistëve, plani i Putinit mund të mos funksionojë dhe tani gjasat janë që ai të pranojë rezultatin e zgjedhjeve presidenciale, duke shmangur kështu sanksione të mëtejshme. Por Rusia mund të kërkojë vende të tjerë për të destabilizuar Ukrainën e re, gjë që nuk është shumë e vështirë, duke parë që forcat e sigurisë, pasi i kanë shërbyer presidentit të korruptuar Viktor Janukoviç, tashmë janë të demoralizuara dhe jo domosdoshmërisht besnike ndaj udhëheqjes së re.

Të gjithë këto kanë ndodhur shumë shpejt. Edhe BE, edhe SHBA janë të shqetësuara me problemet e tyre të brendshme dhe mbeten kryesisht të pavetëdijshme për rrezikun gjeopolitik dhe ideologjik që paraqet Rusia e Putinit. Si duhet të përgjigjen?

Detyra e parë është kundërvënia ndaj përpjekjeve të Rusisë për të destabilizuar Ukrainën. Me “fiscal compact”-in dhe rregulla të tjerë që kufizojnë hapësirën e ndihmës së qeverisë, nevojiten ide të reja. Masa e parë më efektive do të ishte të ofroheshin garanci risku për ata që duan të investojnë apo të bëjnë biznes me Ukrainën. Kjo do të mbante ekonominë në lëvizje, pavarësisht trazirës politike, dhe do u dërgonte një sinjal ukrainasve se BE dhe SHBA – pra qeveritë dhe sektori privat – janë të përkushtuar ndaj tyre. Biznesi do të rendte drejt një tregu të ri dhe premtues nëse do të kompensohej tërësisht, për humbje që do të shkakttoheshin nga ngjarjet politike që janë përtej kontrollit të tyre.

Garancia politike e riskut mund të tingëllojë shumë e ndërlikuar për ta ofruar menjëherë. Në fakt, një garanci e tillë ekziston tashmë. Sigurues privatë si Euler Hermes i Gjermanisë ka vite që e ofrojnë. Po kështu edhe institucione qeveritare, si Agjencia Shumëpalëshe e Garancisë së Investimeve e Bankës Botërore, si dhe Korporata e Investimeve Privatë e SHBA. Megjithatë, këtyre u duhet të vendosin premium-e më të lartë për të ofruar



*Interesi vetiak i regjimit të Putinit bie ndesh me interesat strategjike të Rusisë. Rusia do të përfitonte më shumë nga bashkëpunimi i ngushtë me SHBA dhe BE. Dhe përdorimi i represionit në Rusi dhe në Ukrainë është një autogol. Ekonomia ruse po dobësohet, pavarësisht çmimit të lartë të naftës, për shkak të largimit të kapitalit dhe talenteve*





garanci të reja. Të gjendura përballë këtyre premium-eve të lartë, shumica e bizneseve thjeshtë do të preferonin të hiqeshin mënjane dhe të prisnin deri sa të kalojë furtuna. Prandaj qeveritë e interesuara duhet të marrin funksionet e ofrimit të garancive dhe të përdorin agjencitë e tyre vetëm për të administruar politikat e sigurimeve.

Ato mund të garantojnë humbjet në të njëjtën mënyrë si bëjnë me Bankën Botërore: secila qeveri do të ofronte një infuzion proporcional kapitali dhe pjesën tjetër do ta ofronte në formën e kapitalit të kërkueshëm, që do të ishte i disponueshëm, nëse dhe kur të paguhen humbjet. BE do të duhej të modifikonte “fiscal compact”-in e saj për të përjashtuar kapitalin e kërkueshëm dhe të lejojë që humbjet reale të amortizohen brenda një periudhe të caktuar kohe. Garanci të këtij lloji kanë një tipar të veçantë: sa më bindëse të jenë, aq më pak gjasa ka që të kërkohen. Në fund do të rezultojë që ky proces rigarantimi të jetë krejt pa kosto. Banka Botërore është një shembull i gjallë. pershtatur ne shqip nga bota.al

Duke vepruar me shpejtësi dhe bindshëm, BE mund ta shpëtojë Ukrainën – dhe veten. Ajo që unë propozoj për Ukrainën do të kishte efekt edhe për BE-në. Sa kohë që ekzistojnë kaq shumë burime produktive që rrinë kot, do të kishte kuptim që të përjashtoheshin nga “fiscal compact”-i ata investime që do të paguanin për vetveten. Renzi, për shembull, po mbron pikërisht këtë kurs veprimi.

Putini ka në plan ta shndërrojë Krimenë në një vitrinë, duke hedhur aty 50 miliardë euro në vitet e ardhshëm. Me mbështetjen e Europës, Ukraina mund të bëjë më mirë. Dhe nëse një nismë e tillë shënon fillimin e një politike rritjeje ekonomike që i duhet kaq shumë Europës, atëherë duke shpëtuar Ukrainën Europa vërtetë që do të shpëtonte edhe vetveten. (project syndicate)

---



# Përse populistët do e zhysnin Francën në depresion?

JACQUES ATTALI

**N**uk është qëllimi im që të përpiqem të bind të mos votojnë për Frontin Nacional të gjithë ata nostalgjikët e kolaboracionizmit, të gjithë antisemitët e papenduar, të gjithë ata që thonë se janë antimyslimanë, dhe të gjithë ata që nuk durojnë dot të gjenden përballë një personi me ngjyrë të zezë apo të verdhë në një maternitet. Këtyre njerëzve, më lejoni t'u them vetëm që ndiej keqardhje për ta, për faktin që nuk njohin lumturinë apo gëzimin e zbulimit të dallimeve tek të tjerët, kënaqësinë e të mësuarit të kulturave të ndryshme nga e tyrja. Në fakt, jam shumë i kënaqur që këta njerëz ekzistojnë, për arsye se mua më kujtojnë ata që duan të harrojnë se Fronti Nacional është ende një parti e gatshme të mirëpresë të gjithë racistët dhe të gjithë armiqtë e demokracisë.

Qëllimi im është më modest. Dua t'u drejtohem atyre që më parë kanë votuar për të Majtën apo të Djathtë, të njohura si "parti qeverisëse", dhe tani po bëhen gati të votojnë për Frontin Nacional, bazuar në argumentat e mëposhtëm, që na janë përsëritur deri sa të na vijë ndot, nga liderët dhe kandidatët e asaj partie:

"Socialistët dhe UMP (partia e qendrës së djathtë franceze) janë njësoj, dhe kanë dështuar". Jo, të dy këto parti (plus e Majta ekstreme që nuk ka qenë asnjëherë në gjendje të zbatojë programin e saj) nuk

ofrojnë aspak të njëjtat politika për popullin francez. Reformat fiskale dhe sociale që po zbatohen, për shembull, kritikohen fort nga UMP dhe ata janë të angazhuar që t'i kundërshtojnë.

“Kemi provuar gjithçka dhe nuk funksionon”. Jo, në fakt nuk janë bërë gjithë përpjekjet. Në mënyrë të veçantë, shumë reforma që janë absolutisht jetike duhet të realizohen: ato të autoriteteve rajonale, të reduktimit të shpenzimeve publike, të taksës mbi vlerën e shtuar e njohur si “TVSH sociale”, reforma e arsimit dhe trainimit për punë, një politikë e guximshme integrimi, një hap drejt Europës federale. Ka edhe shumë ndryshime të tjerë që partitë në qeverisje nuk guxojnë t'i bëjnë. Dhe që nuk propozohen as nga Fronti Nacional.

“Unë nuk jam racist, por imigrimi e ka fajin për gjithçka. Ai shpjegon edhe pasigurinë, edhe papunësinë”. Megjithatë, ky pikëvështrim harron që shumica e atyre njerëzve për të cilët flasin janë me nënshtetësi franceze, ndonjëherë prej disa brezash. Dhe mund t'ua heqim nënshtetësinë vetëm nëse i rikthejmë ligjet tanë të imigrimit në kohën e regjimit të Vichy-së. Po kështu, shumë prej tyre bëjnë punë që askush tjetër nuk i do. Gjithashtu, pa imigrimin në masë, do të bëhet e pamundur të financohen pensionet e të moshuarve. Së fundi, problemi i vërtetë, ai i fundamentalizmit fetar do të përkeqësohej përmes një konflikti të drejtpërdrejtë me ata që gjejnë strehë brenda tij, për shkak të mungesës së shpresës tek laicizmi. Kështu që, problemi nuk është imigrimi, por mungesa e mjeteve për të shfrytëzuar burimet nëpër lagje dhe për përfshirjen sociale, në shkolla dhe në punësim.

“Euro e ka fajin për gjithçka. Pa të, nuk do të kishte nevojë për rreptësi buxhetore dhe rritja ekonomike do të rikthehej”. Eshtë me siguri argumenti më absurd: Nëse do të riktheheshim tek franga franceze, të gjithë llogaritë bankare të çdo francezi, të gjithë llogaritë e kursimeve do të rinivelohehin menjëherë me këtë monedhë, e cila do të zhvlerësohej pa vonesë kundrejt Euros. Teksa zotëruesit e llogarive të kursimeve do të shihnin uljen e vlerës së depozitave të tyre, ata do të rendnin të kërkonin hapje llogarish në Euro, për të rikthyer të gjithë asetet e tyre, që tashmë do e kishin humbur një pjesë të vlerës. Prej këtui, franga franceze do të zhvlerësohej edhe më shumë. Normat e interesit do të rriteshin në stratosferë dhe nuk do të kish më mënyra për të shlyer borxhet. Kështu që, heqja dorë nga Euro do të sillte padyshim një rënie masive në vlerën e aseteve për francezët, edhe ata me të ardhura modeste, gjë që do të zhyste të gjithë kombin në një depresion prej të cilit nuk do të ishim në gjendje të dilnim. Përkundrazi, nevojitet më shumë Europë, për t'u mbrojtur prej tepri-meve të globalizimit.

Ju që, ndershmërisht, ose prej dëshpërimit, ose zemërimit jeni gati të votoni në favor të Frontit Nacional, mendojini këta argumenta përpara se ta bëni. Ju lutem votoni këdo, përveç Frontit Nacional. Qoftë edhe një fletëvotimi të bardhë hidheni në kuti. Kursejani kombit tuaj turpin, që do i shkaktohej nëse do i kthente shpinën gjithë atyre vlerave që e bëjnë kaq të madh.



“Euro e ka fajin për gjithçka. Pa të, nuk do të kishte nevojë për rreptësi buxhetore dhe rritja ekonomike do të rikthehej”. Eshtë me siguri argumenti më absurd: Nëse do të riktheheshim tek franga franceze, të gjithë llogaritë bankare të çdo francezi, të gjithë llogaritë e kursimeve do të rinivelohehin menjëherë me këtë monedhë, e cila do të zhvlerësohej pa vonesë kundrejt Euros







# BE dhe sindroma e mbretit të Francës

TIMOTHY GARTON ASH

**D**itën kur u sulmua Bastija në 1789, Mbreti Luigji XVI shkruante në ditarin e tij, “rien”. Shumë pak udhëheqës europianë do të kishin shkruajtur “asgjë” në iPad-ët e tyre sot, por ka një rrezik real që, në përgjigje të thirrjeve revolucionare në të gjithë kontinentin, ata në fakt nuk do të bëjnë asgjë. “Rien” sot ka një fytyrë dhe një emër. Emri është Juncker. Jean Claude Juncker.

Do të ishte katastrofike nëse përgjigja e liderëve europianë do të ishte të merrnin Junckerin dhe ta bënin president të Komisionit Europian. Luksemburgasi i matur ka qëndruar më gjatë se kushdo tjetër në krye të një qeverie të një vendi anëtar të BE, si dhe ka qenë në krye të Eurogrupit gjatë periudhës më të rëndë të eurokrisës. Ndonëse ka aftësi të konsiderueshme si politikan, ai personifikon gjithçka që votuesit e protestës, nga e majta në të djathtë, nuk besojnë tek elitat europiane. Ai është, si të thuash, Luigji XVI i BE-së.

Rreziku qëndron gjithashtu në atë që do të ndodhë brenda Parlamentit Europian. Zhvillimi më i mundshëm është një lloj koalicioni i

madh mes grupeve kryesorë, qendra e majtë, qendra e djathtë, liberalët dhe të paktën disa të gjelbër, për të mbajtur larg partitë antieuropiane. Nëse gjashtë apo më shumë partitë ksenofobe dhe nacionaliste pranojnë udhëheqjen e Marine Le Pen, duke lënë mënjanë dallimet për të krijuar një grup të njohur në parlament, kjo do u japë atyre financime (nga xhepat e taksapaguesve europianë) dhe një pozicion më të fortë në procedurën parlamentare, por sërish jo aq vota sa nevojiten për t'iu kundërvënë një koalicioni të tillë të madh.

Kjo është gjë e mirë? Po, në terma kohëshkurtër. Por vetëm nëse ai koalicioni i madh mbështet më pas reformën e BE-së. Duhet të fillojë, simbolikisht, duke refuzuar për të bërë sërish vajtje-ardhjen absurde dhe të rregullt nga zyrat qendrore në Bruksel tek selia e dytë luksoze në Strasburg, me një kosto prej 180 milionë Euro në vit. Por, nëse koalicioni i madh nuk do të arrijë të përmbushë pritshmëritë e europianëve në pesë vitet e ardhshëm, atëherë vetëm sa do të forcojë votën anti BE në raundin e ardhshëm. Pastaj, të gjithë partitë kryesore do të bëhen përgjegjëse për dështimin.

Një arsye për optimizëm në këtë re me përmasa kontinentale është se, për herë të parë që kur nisën zgjedhjet e drejpërdrejta për parlamentin në 1979, pjesëmarrja në votime nuk pati rënie. Pjesëmarrja ndryshon shumë nga një shtet në tjetrin – në Sllovaki ishte afro 13% – por në Francë, për shembull, shumë më tepër votues shkuan të votojnë në krahasim me zgjedhjet paraardhëse. Ajo që proeuropianët e kanë predikuar për kaq shumë kohë, më në fund u realizua: qytetarët europianë u angazhuan aktivisht në procesin demokratik mbarëeuropian. Por, për ironi të fatit, e bënë këtë për të votuar kundër BE-së.

Atëherë, çfarë po u thoshin europianët udhëheqësve të tyre? Mesazhi i përgjithshëm u përmbledh në mënyrë të përsosur nga karikaturisti Chappatte, me një grup protestuesish që mbanin lart një pankartë ku shkruhej: “Të palumtur” – dhe njëri prej tyre që bërtiste me megafon në drejtim të kutisë së votimit. Janë 28 shtete anëtarë dhe 28 varietete të të Palumturit. Disa prej partive të suksesshme të protestës janë vërtetë në të djathtën ekstreme: në Hungari, për shembull, Jobbik mori 3 vende dhe më shumë se 14% të votave. Shumica, si britanikja Ukip tërheqin votues majtas dhe djathtas, me parulla të tilla si “na riktheni vendin tonë” dhe “shumë të huaj, pak vende pune”. Por në Greqi, vota e protestës shkoi tek Syriza e majtë.

Simon Hix, një ekspert i parlamentit europian, ka identifikuar tre shkolla kryesore të palumturisë: europiano veriorët jashtë eurozonës (britanikët, danezët), europiano veriorët brenda eurozonës (ata gjermanë që i dhanë disa vende partisë antieuro AtD) dhe europiano jugorët brenda eurozonës (portugezët dhe grekët).

Kjo lë jashtë europiano lindorët, të cilët janë të palumtur në mënyrën e tyre. Dhe fakti që të Palumturit vijnë nga drejtime të ndryshëm e bën të vështirë të adresosh problemin. Endrra e votuesve të Syrizas është njëkohësisht makthi i votuesve të Alternative fuer Deutschland.

Megjithatë, një gjë e kanë të gjithë të përbashkët: frika për shanset e jetës së fëmijëve të tyre. Deri afro 10 vjet më parë, supozohej përgjithësisht që gjërat do të bëheshin më mirë për brezin e ardhshëm të europianëve. “Europa” ishte pjesë e një historie më të madhe progresi. Por një sondazh i Eurobarometrit në fillim të këtij viti zbuloi se më shumë se gjysma thonë që jeta për fëmijët e tyre në BE do të jetë më e vështirë se e tyrja.



*Nëse gjashtë apo më shumë partitë ksenofobe dhe nacionaliste pranojnë udhëheqjen e Marine Le Pen, duke lënë mënjanë dallimet për të krijuar një grup të njohur në parlament, kjo do u japë atyre financime (nga xhepat e taksapaguesve europianë) dhe një pozicion më të fortë në procedurën parlamentare, por sërish jo aq vota sa nevojiten për t'iu kundërvënë një koalicioni të tillë të madh*





Tashmë ka një brez të diplomuarish europianë që ndiejnë se janë zhvatur nga një e ardhme më e mirë, që ishin bërë te besonin. Ata janë anëtarë të një klase të re: prekariatit.

Në një moment kaq dramatik për të gjithë projektin europian, ia vlen të rikthehesh në origjinë, në Kongresin e Europës të vitit 1948, kur avokati veteran i PanEuropës, Richard Coudenhove-Kalergi iu drejtua themeluesve të tjerë: “Le të mos harrojmë, miqtë e mi, se Bashkimi Europian është një mjet dhe jo një qëllim”. Kjo është e vërtetë sot, po aq sa atëherë. Bashkimi Europian nuk është një qëllim në vetvete. Ai është një mjet për të realizuar qëllimin e përmirësimit të jetës së qytetarëve të tij.

Kështu që, tani kemi nevojë për t’u fokusuar radikalisht tek ofrimi i këtij përmirësimi për qytetarët. Mjaft me ata debate institucionale të pafund. Pyetja nuk është “më shumë apo më pak Europë”. Pyetja është: më shumë nga çfarë dhe më pak nga çfarë? Për shembull, na duhet më shumë nga tregu i përbashkët për energjinë, telekomunikacionin, internetin dhe shërbimet, por na duhen më pak politika të udhëhequra nga Brukseli për peshkimin dhe kulturën.

Duhet ndërmarrë çdo politikë që krijon qoftë edhe një vend të ri pune për një europian aktualisht të papunë. Cdo centimetër shirit i kuq që nxjerr të papunë dikë duhet grisur. Kjo nuk është kohë për Junckers. Ky moment kërkon një komision europian të të gjithë talenteve, udhëhequr nga dikush me aftësi të provuara si Pascal Lamy apo Christine Lagarde, tërësisht të dedikuar ndaj detyrës për bindjen e legjioneve të të Palumturve se ka një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre, dhe që kjo është në Europë.

Kjo duhet të ndodhë. Por a do të ndodhë? Kam një ndjenjë të frikshme se historianët e ardhshëm do të shkruajnë për zgjedhjet e majit 2014: “Kjo ishte këmbana e alarmit që nuk arriti ta zgjojë Europën”.



# Marshimi i nacionalistëve

JOSCHKA FISCHER

**E**uropa përbëhet nga kombet e vet dhe kështu ka qenë prej qindra vitesh. Kjo e bën bashkimin politik të kontinentit një detyrë kaq të vështirë, edhe sot. Por, nacionalizmi nuk është parimi i ndërtimit të Europës. Përkundrazi, ai ka qenë dhe mbetet parimi i zhbërjes së Europës. Ky është mësimi kryesor që duhet nxjerrë nga përparimi dramatik i partive populiste europiane në zgjedhjet e fundit për Parlamentin European.

Është një mësim që europianët duhej ta kishin nxjerrë tashmë. Luftërat e shekullit të 20 në Europë, në fund të fundit, u luftuan nën flamurin e nacionalizmit – dhe ato pothuajse e shkatërruan tërësisht kontinentin. Në fjalimin e tij të lamtumirës para Parlamentit European, François Mitterrand e distiloi një jetë të tërë përvojë politike në një fjali të vetme: “Nacionalizëm do të thotë luftë”.

Këtë verë, Europa do të përkujtojë 100 vjetorin e shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, e cila e hodhi Europën në humnerën e



dhunës së nacionalizmit modern. Europa do të përkujtojë edhe 70-vjetorin e zbarkimit të Aleatëve në Normandi, që do të vendoste fatin e Luftës së Dytë Botërore në favor të demokracisë në Europën Perëndimore (dhe më vonë, pas fundit të Luftës së Ftohtë, në të gjithë Europën).

Historia e vonë e Europës është e mbushur me përkujtime dhe përvjetorë të tillë, të gjithë të lidhur ngushtë me nacionalizmin. E megjithatë, shpresat e shumë europianëve për të ardhmen duket se gjejnë shprehje pikërisht tek ai, ndërkohë që një Europë e bashkuar, që ka qenë garantuesi i paqes mes popujve europianë që nga viti 1945, shihet si barrë dhe si rrezik. Kjo është domethënia e vërtetë e rezultateve të zgjedhjeve për Parlamentin Europian.

Por vetëm shifrat dhe përqindjet nuk e shprehin shkallën e humbjes që ka pësuar BE. Për aq sa zgjedhjet demokratike përcaktojnë shumicën dhe pakicën – dhe si pasojë shpërndarjen e pushtetit për një periudhë kohe – ato nuk garantojnë gjithmonë një vlerësim të saktë të situatës politike. Zgjedhjet ofrojnë një foto të çastit – një moment të ngrirë. Për të kuptuar tendencat kohëgjata, ne duhet të ekzaminojmë ndryshimin në votën e partive të ndryshme nga një palë zgjedhje, tek të tjerat.

Nëse rezultati i zgjedhjeve të Parlamentit Europian do të gjykohej ekskluzivisht nga fakti që një shumicë dërrmuese e qytetarëve europianë hodhën votën për partitë pro Euro, atëherë do të na shpëtonte pika themelore – rritja dramatike e mbështetjes për partitë nacionaliste euroskeptike në shtete si Franca, Mbretëria e Bashkuar, Danimarka, Austria, Greqia dhe Hungaria. Nëse tendenca vazhdon, atëherë do të bëhet një rrezik ekzistencial për BE-në, pasi do të bllokojë integrimin e mëtejshëm, i cili nevojitet urgjentisht dhe do ta shkatërrojë nga brenda idenë europiane.

Veçanërisht Franca ofron shkak për t'u shqetësuar shumë, sepse Fronti Nacional është vendosur tashmë si forca e tretë politike në vend. "Pushtu Francën, shkatërroj Europën!" është bërë objektivi i Frontit Nacional për zgjedhjet e ardhshme. Pa Franën, në Europë ndodh shumë pak ose asgjë. Bashkë me Gjermaninë, ajo është e domosdoshme për të ardhmen e BE. Dhe askush nuk duhet të ketë dyshime që Fronti dhe votuesit e vet e kanë seriozisht atë që thonë.

Në zemër të krizës politike të Europës është gjendja e keqe ekonomike dhe financiare, që as qeveritë e shteteve dhe as institucionet e BE nuk po e adresojnë. Në vend të forcimit të solidaritetit mbarëeuropian, problemet ekonomike duket se po sjellin një konflikt të madh në shpërndarje. Ajo që dikur ishte një marrëdhënie mes të barabartëve, është kthyer në një përplasje të fortë mes huamarrësve dhe kreditorëve.

Mosbesimi i ndërsjellë që karakterizon këtë konflikt mund të dëmtojë në mënyrë të pandreqshme shpirtin e Unionit dhe të gjithë projektin europian. Europa Veriore është mbërthyer nga frikërat e shpronësimit; jugu është i mbërthyer nga një krizë ekonomike që duket se nuk ka fund si dhe një papunësi e paprecedentë, për të cilën qytetarët bëjnë përgjegjësi veriu – sidomos Gjermaninë. Kriza e borxheve në jug, bashkë me pasojat e masave të rënda të kursimit, shihet thjeshtë si braktisje e parimit të solidaritetit nga veriu i pasur.

Në këtë klimë solidariteti në rënie, nacionalizmit të vjetër iu dhanë



*Në zemër të krizës politike të Europës është gjendja e keqe ekonomike dhe financiare, që as qeveritë e shteteve dhe as institucionet e BE nuk po e adresojnë. Në vend të forcimit të solidaritetit mbarëeuropian, problemet ekonomike duket se po sjellin një konflikt të madh në shpërndarje.*





fitoret në pjatë të argjendtë. Në të vërtetë, kudo ku BE mund të fajësohej për kolapsin e mirëqenies së klasës së mesme, shovinizmi nacional dhe ksenofobia ishin strategji elektorale fituese.

Duke parë dobësinë e Francë dhe rezultatin zgjedhor dramatik atje, si dhe rrugën e çuditshme të Britanisë drejt daljes nga BE, roli udhëheqës i Gjermanisë do të vazhdojë të rritet, gjë që nuk është e mirë as për Gjermaninë dhe as për Europën. Gjermania nuk ka aspiruar asnjëherë për këtë rol. Por fuqia ekonomike dhe qëndrueshmëria institucionale e kanë bërë të pashmangshëm pranimin e tij. Megjithatë, hezitimi i Gjermanisë për të udhëhequr mbetet një problem i madh.

Të gjithë europianët e kanë në gjen që të kundërshtojnë instiktivisht – dhe racionalisht – ndaj çdo lloj forme hegjemonie. Kjo vlen edhe për Gjermaninë. Por të bësh përgjegjëse Gjermaninë për masat e kursimit në jug është vetëm pjesërisht e justifikuar, pasi nuk ishte qeveria gjermane që i detyroi vendet e prekura të kishin nivele të lartë borxhi publik.

Gjermania mund të bëhet përgjegjëse për këmbënguljen e udhëheqësve të saj, që të zbatoheshin njëkohësisht reduktimi i borxhit dhe reformat strukturore si dhe kundërshtimi i tyre për pothuajse çdo lloj politike të orientuar nga rritja ekonomike në eurozonë. Veç kësaj, asnjëri prej kampeve politike në Gjermani nuk është gati të pranojë “problemin gjerman” të unionit monetar (domethënë forcën relative të vendit, që nuk e ka përdorur në dobi të projektit europian në tërësi).

Pyetja tani është se sa shumë do të bëjë Gjermania për Francën, që të shpëtojë Europën. Trysnia mbi Kancelaren gjermane, Angela Merkel si dhe Presidentin e Bankës Qendrore Europiane, Mario Draghi me siguri do të rritet, dhe nuk do të vijë vetëm nga Parisi, por edhe nga Roma, Athina dhe kryeqytete të tjerë.

Për Gjermaninë, alternativa e ndryshimit të kursit tani, është të presë deri kur vendet në borxhe të Europës të zgjedhin qeveri që vënë në dyshim detyrimin e tyre për të paguar. Në Greqi, këto gjëra po thuhën tashmë. Për Europën do të ishte fatkeqësi. Për Gjermaninë, thjeshtë marrëzi.



# DEBATI/A janë eurokratët “armiqtë” e qytetarëve?

**CHRISTOPH PAULY, GREGOR PETER SCHMITZ**

**S**apo kanë kaluar nëntë orë nga java e re e punës, dhe ideja europiane ka sërish nevojë – të paktën figurativisht – për një paketë të re shpëtimi. Disa zyrtarë janë ulur në tryezën e rrumbullakët në zyrën e kryezdhënësit të Komisionit European, duke diskutuar faktin që shtypi, si zakonisht nuk ka qenë shumë miqësor në ditët e fundit.

Njëri prej specialistëve të medias thotë se në gazetët franceze po qarkullon një lajm sipas të cilit Komisioni European ka nxjerrë një rregullore të re, se si fëmijët lejohen të ngjiten në shkallë. Është natyrisht një keqinterpretim, thotë ai – Komisioni do të duhet të nxjerrë një korrigjim. Ndërkohë, media britanike po shfryn furishëm kundër burokracisë së Brukselit, ndonëse rregullat në fjalë janë vendosur nga vetë britanikët. Duket se nevojitet një tjetër korrigjim. Në fund, ata merren me editorialët e Financial Times për gjendjen e eurozonës. “Skeptike, por e parashikueshme”, thotë një zyrtar.

Gjendja sikur përmirësohet pak në një moment gjatë takimit, kur ata

diskutojnë një intervistë me Ministrin e Energjisë të BE, Guenther Oettinger, të cilën e ka dhënë për gazetën Stuttgarter Nachrichten. Në artikull, Oettinger argumenton se numri i komisionerëve të BE – 28 – mund të duket i lartë, por një vend si Gjermania ka 180 ministra dhe sekretarë shteti në nivel federal dhe shtetëror. Kryetitulli i intervistës është një citim i drejtpërdrejtë i Oettingerit: “Në Bruksel, njerëzit punojnë deri në orën 20.00 të premtëve”. Në sallë të gjithë fillojnë të miratojnë me kokë. Të paktën këtë e kanë thënë saktë, thotë njëri.

Më pas, nëpunësit civilë shpërndahen në zyrat e tyre si hoje bletësh, ku sinjalizohen vazhdimisht sa herë që diçka kritike për “Brukselin” shfaqet tek Google News.

### NJË MISHMASH I PAPËRCAKTUESHËM

Kjo është vetëm një pamje e shkurtër e skizofrenisë së përditshme në qendrën nervore të Bashkimit European në Bruksel. Mbi 33 mijë punonjësve të Komisionit “u ben hije” Berlaymont, një ndërtesë e bukur 13-katëshe në qendër të Lagjes Europiane të Brukselit. Komisioni European është një institucion shumë i fuqishëm, por është një forcë që punonjësit e tij bëjnë maksimumin për të mos e treguar. Në muret e tij është e pranishme frika se mos e humbasin këtë pushtet.

Komisioni është një mishmash i papërcaktueshëm qeverish dhe agjencish publike – një që e bën politikën e jashtme si një Ministri e Jashtme dhe rregullon konkurrencën në një mënyrë të tillë që zakonisht e sheh tek zyrat kombëtare të karteleve. Shumica e politikave dhe direktivave që zbatohen në ligjet kombëtarë të vendeve anëtarë të Bashkimit European e kanë fillesën pikërisht tek Komisioni European. Dhe për shkak se Komisioni ka përgjegjësi për monitorimin e zbatimit të ligjit european, ai ka gjithashtu aftësinë të vendosë gjoba në miliarda euro. Këto masa ndëshkuese mund të miratohen kundër kompanive të Internetit si Google apo Microsoft, nëse këta shkelin rregullat e konkurrencës në BE, por edhe kundër një shteti si Gjermania nëse Komisioni zbulon se ka shkelur rregulloret, përsëmbull duke ofruar një paketë shpëtimi të financuar nga shteti për një kompani si prodhuesi i automjeteve “Opel”, ditët e të cilit dukej se ishin të numëruara shumë vite më parë, kur kompania mëmë e saj në Amerikë, “General Motors” u godit rëndë nga kriza.

Komisioni është një vend shumë tërheqës për të punuar: Për çdo pozicion aty vijnë me qindra aplikime për punë nga i gjithë kontinenti. Nëse një 27-vjeçar siguron një vend pune këtu, atëherë nuk është e pazakontë që ai të negociojë probleme që lidhen drejtpërdrejtë me interesat e një CEO-je apo një udhëheqësi të një qeverie – një fenomen që është më tipik për kompani të mëdha globale konsulence, si për shembull McKinsey. Nëse ia dalin të ngjiten drejt pozicioneve më të lartë të stafit në Komision, nëpunësit civilë në Bruksel mundet që të fitojnë një pagë edhe më të lartë se kancelari i Gjermanisë – kryesisht për shkak të zbritjeve dhe taksave më të ulëta.

### FOKUS MBI MODESTINË

Por mes punonjësve të Komisionit, fokusi vihet mbi modestinë. Ata kanë qejf ta përmendin që, ndryshe nga liderët e tjerë europianë, Presidenti i Komisionit Jose Manuel Barroso nuk ka një avion të tijin dhe fluturon me linjat ajrore komerciale. Takimet zyrtarë zhvillohen në një “korridor pritjesh”, orënditë me lëkurë të të cilit janë kaq të



*Komisioni është një mishmash i papërcaktueshëm qeverish dhe agjencish publike – një që e bën politikën e jashtme si një Ministri e Jashtme dhe rregullon konkurrencën në një mënyrë të tillë që zakonisht e sheh tek zyrat kombëtare të karteleve. Shumica e politikave dhe direktivave që zbatohen në ligjet kombëtarë të vendeve anëtarë të Bashkimit European e kanë fillesën pikërisht tek Komisioni European*





vjetëruara, saqë një vizitor aziatik një herë ofroi që të sillte orendi më të respektueshme. Atyre u pëlqen gjithashtu të mburren që Komisioni, i cili ka përgjegjësi administrative për rreth 500 milionë qytetarë të BE-së, ka pothuajse të njëjtin numër të punësuarish në bordero sa edhe qyteti i Mynihut.

Ka arsye të forta që zyrtarët e BE të shfaqen modestë për botën e jashtme. Ata janë plotësisht të vetëdijshëm, se si janë shndërruar në “kurbanë” për një Europë që është bërë gjithnjë e më e pasigurtë në vetvete, në mesin e krizës financiare globale dhe krizës europiane të borxheve dhe euros. Socialdemokratët, kristiandemokratët, liberalët dhe euroskeptikët me parti si Alternativa për Gjermaninë – qofshin këta në Berlin, Athinë apo Romë – të gjithë duken të gatshëm t’u vërsulen eurokratëve të Komisionit në prag të zgjedhjeve të Parlamentit European, që fillojnë të enjten e ardhshme. Ata thonë se pjesëtarët e Komisionit kanë një zell të tepruar në punën e tyre, duke miratuar rregullore për gjëra që fillojnë të turshitë dhe mbarojnë tek kokat e dushit.

*Ka arsye të forta që zyrtarët e BE të shfaqen modestë për botën e jashtme. Ata janë plotësisht të vetëdijshëm, se si janë shndërruar në “kurbanë” për një Europë që është bërë gjithnjë e më e pasigurtë në vetvete, në mesin e krizës financiare globale dhe krizës europiane të borxheve dhe euros.*

Kjo temë doli në pah gjatë debatit të fundit në televizion mes dy kandidatëve kryesorë në zgjedhjet për parlamentin european, kandidatit kristiandemokrat Jean-Claude Juncker dhe kandidatit socialdemokrat, aktualisht president i Parlamentit European, Martin Schulz. Në disa raste, Schulz deklaronte me zemërim se nuk është “një eurokrat”, një fjalë që e konsideron si pezhorative.

Njerëzit nuk duken se duan ta bëjnë dallimin. Edhe nëse shtetet anëtarë të BE apo komunitetet lokale janë përgjegjës për shtytjen e rregulloreve të reja, është më e lehtë për shumë prej tyre që thjeshtë të fajësojnë Brukselin. Atyre nuk duket se u bëhet vonë që ndonjëherë ka kuptim të hartohen rregullore unike për të gjithë BE-në, në vend të një serie rregulloresh kombëtare. Është e pashmangshme që, ata që gjenden përballë një trysnie të tillë zakonisht mbyllën në vetvete, dhe me kalimin e dekadave eurokratët kanë zhvilluar një esprit de corps të vërtetë. Ata e shohin veten si njerëz që keqkuptohen, të cilët janë të vetmit që munden të shpëtojnë idenë europiane sepse, besojnë ata, janë të vetmit që e kuptojnë.

Pak njerëz e njohin më mirë këtë lloj dikotomie, se sa Johannes Laitenberger, shefi i Kabinetit të Barrosos. Ai ka një fytyrë rinore dhe mban nga ai lloj kostumi që zyrtarët në Komisionin European duket sikur i blejnë me dhjetëra kur fillojnë punë. Laitenberg ka lindur në Hamburg dhe është rritur në Portugali. Kur ai dhe shefi i tij janë vetëm, ata flasin portugalisht.

Laitenberg thotë se e kupton shumë mirë mënyrën se si njerëzit e imagjinojnë jetën e përditshme në Bruksel. “Ata mendojnë që ne të gjithë ngasim makina që nuk ndosin ambientin, shkojmë me to në zyrat tona shumë të mëdha dhe ulemi me njëri-tjetrin në mëngjes dhe mendojmë se si të krijojmë rregullore të reja për qytetarët e Europës”, thotë ai. Laitenberg thotë se herë pas here mund të ketë shfaqje të një zelli të tepruar në administratën e tij, por shton se rregulloret e BE përgjithësisht adresojnë probleme për të cilët debatet ligjore janë duke ndodhur në nivel kombëtar. Ai thotë gjithashtu se vendimet më të rëndësishme mund të merren vetëm nga komisionerët – ku secili përfaqëson një shtet anëtar – dhe që propozimet ligjore duhet të miratohen nga Parlamenti European dhe nga Këshilli European, organi i fuqishëm që përfaqëson udhëheqësit e 28 shteteve anëtarë. “Si zyrtarë të BE-së ne punojmë si marinarë”, shpjegon ai.

“Janë komisionerët e legjitimuar politikisht që qëndrojnë në urën e kapitenit, dhe që janë të dukshëm për gjithkënd”.

Po sa të dukshëm janë? Politikanë si Androulla Vassiliou, komisioneri qipriot për arsimin, kulturën dhe multilingualizmin, apo Maros Sefcovic, komisioneri sllovak për marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe administratën, nuk janë aspak emra që njihen në familjet europiane. Organizimi aktual – një komisioner për secilin shtet anëtar – do të mbetet i tillë sepse 28 shtetet anëtarë të BE-së hodhën poshtë planet origjinalë për të reduktuar numrin e vendeve në Komision. Kjo do të thotë që kakofonia e krijuar prej shumë komisionerëve të panjohur dhe të papërvojë ka gjasa të vazhdojë. (Der Spiegel)

---



# Big-Bang-u i Europës, 10 vjet më vonë

Daniel Gros

---

**D**hjetë vjet më parë, tetë vende të ish bllokut sovjetik, bashkë me shtetet ishullorë të Maltës dhe Qipros hynë në Bashkimin Europian, duke e rritur numrin e anëtarëve nga 15 në 25. Në atë kohë, ekzistonte frika se ky zgjerim në lindje do të rriste tensionet brenda BE-së, për arsye se anëtarët e rinj nga Europa Qendrore dhe Lindore ishin të varfër dhe disa kishin sektorë bujqësorë shumë të mëdhenj. Për arsye se Europa shpenzon kryesisht për rajonet e varfër dhe fermerët, të shumtë ishin ata që u shqetësuan se një zgjerim i tillë do ia rriste shumë barrën buxhetit të BE-së.

Në fund, ky problem u zgjidh përmes një kompromisi tipik europian, që lejoi vazhdimin e zgjerimit, ndonëse buxheti në raport me GDP-në e Europës u zvogëlua. Bujqësia tashmë është zhdukur si temë kryesore në axhendën e BE-së. Për më tepër, planifikimi sipas Kuadrit Financiar Shumëvjeçar e bën të qartë se problemi i “kush paguan për kë” do të duhet të adresohet vetëm një herë në shtatë vjet.

Qëllimi i integritimit ekonomik është t'i japë shtytje rritjes së GDP-së dhe përmirësojë standartet e jetesës. Parë nga ky këndvështrim, zgjerimi ka funksionuar mirë. Vendet në tranzicion kanë bërë përparim të konsiderueshëm gjatë dekadës së fundit.

Në mesin e viteve nëntëdhjetë, GDP për frymë i shumë vendeve në tranzicion ishte sa një e katërta apo një e treta e shumicës së 15 vendeve anëtarë të BE-së (sa i përket fuqisë blerëse). Një pjesë e kësaj distance ishte reduktuar tashmë, kur shtetet e rinj anëtarë u futën më në fund në BE, por procesi i konvergencës ka vazhduar pavarësisht krizës financiare.

Të ardhurat e vendeve të rinj anëtarë kanë arritur në afro 2/3 e 15-shes së dikushme. Për më tepër, anëtarët e rinj që ishin më të varfër përfituan më shumë (ndryshe nga vendet më të varfër të ish 15-shes, si Portugalia dhe Greqia, që tani u janë rikthyer niveleve të të ardhurave të vitit 2009). Konvergjenca është arsyeja përse ata që kërkojnë punë nga shtetet anëtarë të lindjes së Europës, tani kanë vërsuar në tregjet e punës së 15-shes së pasur.

Fakti që anëtarët e rinj ishin fillimisht shumë më të varfër, e që në krye të herës ishte burim tensionesh, tani ka rezultuar një burim avantazhi ekonomik për të dy palët, pasi kompanitë e 15-shes së dikurshme të BE (sidomos kompanitë gjermane), tani mund të zhvendosin operacionet që kërkojnë numër të madh punonjësish në shtetet më të varfër (outsourcing). Ata kanë fituar sa i përket konkurrueshmërisë globale, ndërkohë që shtetet e anëtarësuar rishtaz përfituan për sa u përket investimeve të huaj direkte, krijimit të vendeve të punës dhe transferimit të njohurive. Në terma ekonomikë, zgjerimi ka qenë një propozim me dobi reciproke.

Sigurisht, aspekte të tjerë të zgjerimit nuk kanë funksionuar kaq mirë. Një pjesë e madhe e ndihmës që ka ardhur prej buxhetit të Bashkimit European në drejtim të anëtarëve të rinj është përdorur për projekte prestigji që kanë pasuruar kompanitë lokale të ndërtimit. Dhe ndonëse ky problem nuk është specifik vetëm për anëtarët e rinj – e njëjta gjë ndodh në vende si Italia apo Greqia, me sistemet e tyre administrative të ngadaltë dhe joefikasë dhe korrupsionin e madh – ai u bë edhe më akut prej zgjerimit: e vërteta është që në shtetet lindore gjen sot administrata publike të një cilësie më të ulët se sa në bërthamën e BE-së.

Kështu që, zgjerimi duhet të shihet si një proces i kualifikuar. Edhe një prej frikërave më të mëdha, ajo që institucionet e BE do të mbingarkoheshin me përthithjen e njëkohshme të dhjetë anëtarëve të rinj, nuk u konkretizua asnjëherë. Shtetet e rinj anëtarë janë integruar shumë natyrshëm në institucionet e Bashkimit European, aty ku mbrojnë interesat e tyre kombëtarë në po të njëjtën mënyrë si shtetet e vjetër anëtarë. Vështirësitë që ka përjetuar Bashkimi European gjatë viteve të fundit kanë shumë pak të bëjnë me rritjen e numrit të shteteve anëtarë, që tani ka arritur 28.

Pasoja më e rëndësishme e zgjerimit të BE-së drejt lindjes ka qenë një që shumë pak vetë e kane menduar në atë kohë: ai e afroi BE-në me Rusinë. Dhe për një Rusi që është bërë autoritare dhe ka parë se si BE mund të transformojë shtete në tranzicion në demokraci të suksesshme, Europa është shumë pranë për t'u ndjerë rehat. Perspektiva e një begatie dhe lirie relative ka qenë kaq joshëse për popullin e Ukrainës, sa i bëri ata që të rrëzojnë një president që

//  
një prej frikërave më të mëdha, ajo që institucionet e BE do të mbingarkoheshin me përthithjen e njëkohshme të dhjetë anëtarëve të rinj, nuk u konkretizua asnjëherë. Shtetet e rinj anëtarë janë integruar shumë natyrshëm në institucionet e Bashkimit European

//





preferoi Unionin Euraziatik të udhëhequr nga Rusia, në vend të një marrëveshjeje asociimi me BE-në.

Fatkeqësisht, një pakicë jo e vogël në lindje të Ukrainës nuk ndan këtë “vokacion European” dhe ndihet e kërcënuar nga ngjarjet e fundit. Rusia i mbështet këto tendenca dhe ka përdorur ushtrinë si dhe mjete të tjerë për të shkaktuar tensione, për arsye se regjimi i saj do të ndihej i kërcënuar nga shembulli i gjallë i një Ukraine europiane që është demokratike dhe e begatë.

Kështu që, dhjetë vjet më vonë, zgjerimi rezulton të jetë ndryshe nga sa pritej. Sfidat e brendshme kanë qenë të menaxhueshme, por tani BE duhet të përballet me një sfidë të jashtme, për të cilën nuk është e mirëpërgatitur. Ne nuk do të na duhet të presim një dekadë, për të parë nëse BE mund të ndihmojë për të stabilizuar Ukrainën, në të njëjtën kohë që qetëson Rusinë, udhëheqja e të cilës ndihet e kërcënuar nga vlerat e saj themelore të demokracisë dhe sundimit të ligjit.

***Drejtor i Qendrës për Studime Politike Europiane në Bruksel***

---



# Kriza e eurokratëve

Paul Krugman

---

**N**jë shekull më parë, Europa u vetëcopëtua gjatë një periudhe që u bë e njohur si Lufta e Madhe – katër vite vdekje dhe shkatërrim në një shkallë të paprecedentë. Më vonë, konflikti mori emrin Lufta e Parë Botërore – për arsye se një çerek shekulli më vonë, Europa “ia nisi nga fillimi”.

Por kjo ka ndodhur shumë kohë më parë. Është e vështirë të imagjinosh luftën në Europën e sotme, e cila është rritur sëbashku me vlerat demokratike dhe po ndërmerr madje hapat e parë drejt bashkimit politik. Në fakt, teksa shkruaj këto reshta, në të gjithë Europën po zhvillohen votime, jo për të zgjedhur qeveritë kombëtare, por anëtarët e Parlamentit European.

Parlamenti ka kompetenca shumë të kufizuara, por vetë ekzistenca e tij është një triumf për idenë europiane.

Por ka një gjë: një numër i madh votash ka gjasa të shkojë për ekstremistët e krahut të djathtë, që janë armiqësorë edhe ndaj vetë atyre

vlerave që i bëjnë zgjedhjet të mundura. Le ta themi kështu: Disa prej fituesve më të mëdhenj në zgjedhjet europiane me gjasa do të marrin anën e Vladimir Putinit në krizën e Ukrainës.

E vërteta është se projekti europian – paqja e garantuar prej demokracisë dhe begatisë – është në hall të madh. Kontinenti vazhdon të ketë paqe, por po i mungon begatia, dhe në një masë më të vogël, demokracia. Dhe nëse Europa ngec, kjo do të jetë një gjë e keqe jo vetëm për Europën, por për të gjithë botën.

Përse është në telashe Europa?

Problemi imediat është performanca e dobët ekonomike. Euro, monedha e përbashkët europiane, duhej të ishte hapi kulmant i integritetit ekonomik të kontinentit. Por, ai u shndërrua në një kurth. Në fillim krijoi një vetëkënaqësi të rrezikshme, teksa investitorët kanalizuan sasi të mëdha parash për Europën jugore, të pavëmendshëm ndaj risqeve. Më pas, kur bumi ekonomik ia la vendin krizës, vendet huamarrës u gjendën “të prangosur”, të paaftë të rifitonin konkurrueshmërinë e humbur, pa kaluar në disa vite papunësi të nivele të Depresionit të madh.

Problemet e Euros janë përkeqësuar prej politikave të këqia. Udhëheqësit europianë këmbëngulnin dhe vazhdojnë të këmbëngulin, pavarësisht provave, se kriza lidhet vetëm me papërgjegjshmërinë financiare, dhe ata kanë imponuar masa të tmerrshme shtrëngimi, të cilët vetëm e përkeqësojnë më tej situatën e rëndë.

Lajmi i mirë është se pavarësisht gjithë këtyre hapave të papërshtatshëm, Euro vazhdon të qëndrojë në këmbë, duke befasuar shumë analistë – përfshirë edhe mua vetë – që mendonin se do të shuhej. Nga vjen kjo aftësi vetëshëruese? Një pjesë e arsyes është se Banka Qendrore Europiane i ka qetësuar tregjet duke premtuar se do të bëjë “çdo gjë që duhet” për të shpëtuar Euron, deri në blerjen e bonove qeveritare për të mos lejuar që normat e interesit të rriten shumë. Përtej kësaj, elita europiane mbetet thellësisht e angazhuar ndaj projektit, dhe deri tan asnjë qeveri nuk ka qenë e gatshme të largohet nga radhët.

Por kostoja e këtij kohezioni të elitës është një rritje e distancës mes qeverive dhe të qeverisurve. Duke shtrënguar radhët, elita ka garantuar praktikisht që nuk do të ketë zëra të moderuar që do të shprehnin mospajtim me ortodoksinë e politikave të derisotme. Dhe kjo mungesë mospajtimi të moderuar ka forcuar grupe si Fronti Nacional në Francë, kandidatja kryesore e të cilit për Parlamentin Europian denoncon “një elitë teknokrate që u shërben interesave të Amerikës dhe të oligarkisë financiare europiane”.

Ironia e hidhur këtu është se elita e Europës në fakt nuk është teknokrate. Krijimi i Euros u bë për arsye politike dhe ideologjike, dhe jo si vazhdim i një analize ekonomike të kujdesshme (e cila në fakt, që në fillim sugjeronte se Europa nuk ishte gati për një monedhë të përbashkët). E njëjta gjë mund të thuhet për masat shtrënguese: të gjithë studimet ekonomike që supozohej se justifikonin këto politika janë diskredituar, e megjithatë politikat nuk kanë ndryshuar.

Dhe zakoni i elitës europiane që të maskojë ideologjinë si ekspertizë, që të pretendojë se ajo që ai do të bëjë është në fakt ajo që duhet bërë, ka krijuar një deficit legjitimiteti. Ndikimi i elitës ngrihet



*Problemet e Euros janë përkeqësuar prej politikave të këqia. Udhëheqësit europianë këmbëngulnin dhe vazhdojnë të këmbëngulin, pavarësisht provave, se kriza lidhet vetëm me papërgjegjshmërinë financiare, dhe ata kanë imponuar masa të tmerrshme shtrëngimi, të cilët vetëm e përkeqësojnë më tej situatën e rëndë*



mbi prezumimin e një ekspertize më të lartë: kur këta pretendime për ekspertizë rezultojnë të rremë, atëherë ajo nuk ka asgjë ku të mbështetet.

Deri tani, siç e kam thënë, elita ka qenë e aftë të qëndrojë e bashkuar. Por ne nuk e dimë sa mund të zgjasë, dhe në skaje janë disa njerëz shumë të frikshëm që po presin.

Nëse jemi me fat – dhe nëse zyrtarët në Bankën Qendrore Europiane, të cilët janë më pranë të qënurit teknokratë të aftë se sa elita, veprojnë me guximin e duhur kundër rrezikut të deflacionit – atëherë mund të shohim një rimëkëmbje të vërtetë ekonomike në vitet e ardhshëm. Kjo gjë mund të ofrojë një frymëmarrje, një shans për ta rikthyer në shina projektin europian si një i tërë.

Por vetëm rimëkëmbja ekonomike nuk do të mjaftojë. Elita europiane duhet të kujtohet se çfarë domethënie ka realisht projekti. Është e tmerrshme të shohësh kaq shumë europianë që hedhin poshtë vlerat demokratike, por të paktën një pjesë të fajit e kanë zyrtarët, të cilët duken më shumë të interesuar për stabilitetin e çmimeve dhe korrektësinë fiskale, se sa për demokracinë.

Europa moderne është ndërtuar mbi një ide fisnike, por kjo ide ka nevojë për më shumë mbrojtës. (International New York Times)

---





# Asgjë e re nga fronti i Europës

**Denis McShane**

Ka një hendek në rritje mes elitave europiane dhe qytetarëve të Europës. Zgjedhjet për Parlamentin European e kanë ekspozuar si kurrë më parë këtë ndarje. Ose të paktën kështu do të mendonte kushdo që lexon shtypin britanik apo francez, ose që dëgjon lajmet në Londër dhe Paris. Ata e shohin rezultatin e zgjedhjeve për Parlamentin European si një moment vendimtar, pas të cilit politika nuk do të jetë kurrë më e njëjta. Megjithatë, këto ndjenja alarmiste reflektojnë shumë më tepër karakterin me ulje-ngritje të politikës franceze dhe britanike. Ndjenjat negative të votuesve pasqyrojnë një fenomen tërësisht të politikës së brendshme, për të cilin Europa, BE dhe Komisioni shërbejnë thjeshtë si valvul shfryrëse. Parë nga një këndvështrim më i gjerë, nuk ka ndodhur ndonjë gjë kushedi çfarë. Ishte e njëjta pjesëmarrje e ulët në të gjithë Europën, afro 43% – gjashtë nga dhjetë votues praktikisht thanë se zgjedhjet nuk u interesojnë.

## Rikthimi i gardës së vjetër

Veç kësaj, ata praktikisht votuan të njëjtët njerëz. 569 nga 751 anëtarët e Parlamentit European (ose 76%) vijnë prej partive të mëdha – kristian demokratë, socialdemokratë, liberalë dhe të gjelbër – të cilat udhëheqin edhe në shumicën e shteteve të Europës, në koalicione të shumëllojshëm.

Qeveritë në pushtet në të majtë e në të djathtë – Merkel në Gjermani, Renzi në Itali, Tusku në Poloni, Orbani në Hungari, Rutte në Holandë – patën rezultate të mirë. Pati përjashtime. Syriza, partia e majtë populiste në Greqi ku regjimi i masave të kursimit ka qenë veçanërisht “mizor”, fitoi me një avantazh të ngushtë ndaj konservatorëve të Demokracisë së Re, që janë në pushtet. Por Syriza nuk bën thirrje për heqje të Euros apo që Greqia të dalë nga BE. Ajo kërkon thjeshtë një lehtësim të rregullave fiskalë sipas ideve të qeverisë britanike të udhëhequr nga konservatorët, ku borxhi dhe deficieti janë sa dyfishi i limiteve që ka vendosur eurozona. Po kështu, Banka e Anglisë ka printuar kartemonedha, a thua në krye aty është John Maynard Keynesi. Në fakt, e majta ekstreme në Europë pati rezultat relativisht të mirë dhe grupi i saj në Parlamentin Europian është rritur. Por me vetëm 47 eputetë – ose 6% të të gjithë vendeve – nuk është se do ta bëjë Europën të kuqe.

### Franca: Nga komunistët, tek Fronti Nacional

Marine Le Pen, kreu i dinastisë së djathtë Le Pen – pothuajse një familje mbretërore në Francë – e shkundi pemën, duke fituar 25% të votave. Kjo është pak a shumë e njëjta përmasë e elektoratit francez që ka votuar rregullisht për komunistët francezë, mes viteve 1945 dhe 1975. Në zgjedhjet e para direkte për Parlamentin Europian në vitin 1979, komunistët francezë morën 21% të votave dhe 19 deputetë. Në fakt, deputeti më jetëgjatë është një komunist francez që është zgjedhur që në atë kohë.

Ashtu si Marine Le Pen, udhëheqësi i komunistëve francezë, Georges Marchais më parë shfrynte shumë kundër burokratëve të Brukselit. Edhe ai kërkonte që në Francë mos të futej krah pune i huaj “pasi vendet francezë të punës u duhen lënë punëtorëve francezë”. Dhe kryebashkiakët komunistë në Francë sheshuan me buldozerë ndërtesat e ngritura nga imigrantë myslimanë – ashtu si Marine Le Pen dhe Fronti Nacional flasin sot me tërbim kundër myslimanëve në Francë. Plus ça change...

Kryeministri i Francës, Manuel Valls e përshkroi votën për Frontin Nacional ekstrem si një “tërmet”. Por me siguri ai nuk mund të ketë harruar se si babai i Marine Le Pen, Jean-Marie Le Pen mundi kandidatin socialist për president, Lionel Jospin në garën e vitit 2002. Ajo ishte një tronditje kombëtare shumë më e madhe, se sa disa deputetë të Frontit Nacional për Parlamentin Europian, që shkojnë të kërkojnë paga dhe dieta bujare në Strasburg, aty ku mblidhet Parlamenti Europian.

Në Britani, partia antieuropiane UKIP doli mirë në zgjedhje. Ajo mori më shumë vota se sa konservatorët, laburistët apo liberal demokratët, që kontrollojnë Dhomën e Ulët të parlamentit britanik. Por votuesit britanikë e treguan se çfarë mendojnë për këto zgjedhje, pasi shtatë në dhjetë prej tyre qëndruan në shtëpi dhe nuk shkuan fare të votojnë.

### Kohë për votë proteste

Zgjedhjet për Parlamentin Europian në shumë shtete janë diçka ndërmjet votës së protestës, për t’u dhënë një “shkelm” partive të establishmentit politik brenda vendit, dhe një shansi për të dërguar gjithfarësoj kandidatësh të çuditshëm në Parlamentin Europian, duke përfshirë këtu edhe ekspertë të shfaqjeve të UFO-ve. Sistemi i pastër proporcional i votimit që përdoret në nivel europian, lejon disa deputetë të “shëmtuar” nga partitë neofashiste dhe antisemite që të zgjidhen edhe ata. Por ata kanë prirjen të lihen mënjane dhe nuk kanë kurfare ndikimi.



*Zgjedhjet për Parlamentin Europian në shumë shtete janë diçka ndërmjet votës së protestës, për t’u dhënë një “shkelm” partive të establishmentit politik brenda vendit, dhe një shansi për të dërguar gjithfarësoj kandidatësh të çuditshëm në Parlamentin Europian, duke përfshirë këtu edhe ekspertë të shfaqjeve të UFO-ve*



Logjikisht, dy politikanët më të bashkuar në mospëlqimin që kanë për BE-në, Marine Le Pen dhe Nigel Farage, duhet të lidhen mes tyre. Ata së bashku kanë 50 deputetë pas këtyre zgjedhjeve. Por Farage thotë se Fronti Nacional është “toksik” dhe mbart në vetvete antisemitizmin – një akuzë që Le Peni e mohon dhe që e ka shtyrë atë të ngrejë padi kundër farage.

Problemi për deputetët e ekstremeve, tani që janë zgjedhur në Parlamentin Europian, është se ata rrallëherë bien dakord për ndonjë gjë. Madame Le Pen, nga ana e saj, thotë se do të bllokojë punimet e parlamentit. Dhe deputetët e UKIP kanë thënë tashmë se do të tërheqin pagat dhe dietat, por do të qëndrojnë në Angli. Ata kanë në plan të bëjnë fushatë për një referendum për daljen e Britanisë nga BE. Kryeministri David Cameron ka premtuar një referendum të tillë për në vitin 2017, nëse rizgjidhet vitin tjetër. Ai thotë se dëshiron që Britania të qëndrojë në BE, por vetëm nëse i bëhen lëshime të mëdhenj, që do i mundësonin Britanisë të bëhej një shtet gjysmë i shkëputur nga BE-ja.

Gjithçka ende në ajër

“

*Pra, zgjedhjet për Parlamentin Europian nuk kanë zgjidhur asgjë. Ujditë e bëra korridoreve do të vazhdojnë. Kompromisi dhe konsensusi do të përcaktojnë legjislacionin e BE. Ekstremet e majtë dhe të djathtë do të mbeten në skaje*

”

Zgjedhjet për Parlamentin Europian 2014 duhej të ishin një garë mes dy kandidatëve për president të Komisionit Europian – socialdemokratit gjerman Martin Schulz dhe veteranit luksemburgas të kristian demokratëve, Jean-Claude Juncker. Por Schulzi nuk ka fituar aq deputetë sa i duhen për të pretenduar postin ndërkohë që, ndonëse grupi i djathtë i Junckerit është më i madhi, me 212 deputetë nga 751, ai ka patur rënie të numrit të deputetëve. Kjo gjë e dobëson pretendimin e tij për postin e presidentit të Komisionit.

Kështu që, do të jenë 28 krerët e qeverive dhe shteteve që do të takohen dhe japin postet e presidentit të Komisionit, të Këshillit Europian, si dhe poste të tjerë, përfshirë atë të kreut të politikës së jashtme të BE.

Pra, zgjedhjet për Parlamentin Europian nuk kanë zgjidhur asgjë. Ujditë e bëra korridoreve do të vazhdojnë. Kompromisi dhe konsensusi do të përcaktojnë legjislacionin e BE. Ekstremet e majtë dhe të djathtë do të mbeten në skaje.

Nuk ka një përgjigje ndaj frikërave për mbërritjet në masë të imigrantëve. Marrëveshja e Tregtisë së lirë BE-SHBA do të mbetet sërish e vështirë për t’u përmbyllur, pasi votuesit europianë janë nervozë kur flitet për një ulje të proteksionizmit, sa i përket kujdesit shëndetësor, apo edhe industrive kulturore dhe të argëtimit.

Do të ketë gjithashtu më shumë trysni ndaj GAFA-s – Google, Apple, Facebook dhe Amazon – pasi edhe e djathta, edhe e majta në Europë nuk pëlqejnë fuqinë monopoliste të monstrave amerikane të internetit. Pas këtyre zgjedhjeve, 26 milionë europianët e papunë nuk ka gjasa të gjejnë një vend pune. Debati britanik për daljen e Britanisë nga BE do të vazhdojë. Me pak fjalë, asgjë e re nga fronti i Europës.

*\* Ish Ministër për Europën i Mbretërisë së Bashkuar*



# BE - Nevoja për një vizion të ri

**NINA DOS SANTOS**

---

Më shumë se gjashtë dekada më parë, themeluesi i Lëvizjes Europiane, Jean Monnet ndau vizionin e tij për unionin që po lindte, duke e propozuar parandë si një mënyrë për të shëruar plagët e dy luftërave botërore. “Shkrirja” e lidhjeve ekonomike të Europës, tha ai, do i detyronte kombet që “të shkrinin në një edhe sovranitetin e tyre, në atë të një shteti të vetëm europian”.

Për francezin, Europa federale ishte progridi i natyrshëm i stabilitetit të rigjetur të bllokut.

Disa shtete që e mendonin njësoj, objektivat e përbashkët të cilëve ishin po kaq të qartë, do të dorëzonin me dëshirë qeveritë e tyre, për të mirën e madhe të grupit të shteteve europianë.

Ishte viti 1952. Një kohë kur e ardhmja premonte shumë pas tmerreve të kaluarës dhe çdo gjë dukej e mundur – qoftë edhe krijimi i një pseudo shteti. Një vend që sot njihet si Bashkimi Europian.

Rikthehemi në të tashmen, dhe ndonëse Bashkimi Europian ka disa organe të përbashkët qeverisjeje, si komisioni dhe parlamenti, është e qartë që nuk



bëhet fjalë për “shtetet e bashkuar” që dëshironte Monnet. Ata shtete me bindje dhe besime të thellë dhe të përbashkët.

“Zamka” që mbante të bashkuara ideologjitë e përbashkëta u dobësua dhe u shkri me rënien e Murit të Berlinit.

Që atëherë, një krizë mes shteteve që ndajnë monedhën e përbashkët ka rihapur plagët e vjetra. Ironikisht, në vend që t’i bashkojë më shumë, kriza financare ka rrezikuar t’i ndajë një herë e mirë.

Dhe kjo na çon tek pyetja themelore: nëse detyra kryesore e BE nuk është më që të garantojë paqen, dhe nëse nuk mund të garantojë as begatinë, atëherë cili duhet të jetë roli i saj?

I lindur nga rrënojat e të kaluarës së trazuar të Europës, BE ka arritur shumë gjëra për anëtarët e tij.

U ka mësuar qytetarëve vlerën e kompromisit mbi dhunën, duke ofruar mbrojtje dhe forcë me shifra.

Ka shtuar begatinë, falë lëvizjes së lirë të mallrave dhe krahut të punës, rezultate këta të tregut të përbashkët. Ndërkohë, të drejtat e konsumatorit dhe punëtorëve janë forcuar dhe shëndeti i tyre është përmirësuar.

Por BE është larguar gjithashtu nga koncepti i vet fillestar, me radhët e veta të tejfryra prej një makinerie burokratike me qendër në Bruksel që, sipas kritikëve, po e mbyt industrinë dhe po detyron shtete anëtarë si Mbretëria e Bashkuar që të largohen.

Kufijtë e bllokut europian janë dyfishuar me përfshirjen e ish vendeve komunistë, duke e shtrirë deri në limitet e vet definicionin e Europës, gjë që e ka bërë anëtarësimin në këtë klub dikur elitar të duket më shumë si një mjet i dobishëm i politikës së jashtme, se sa një vizion i përbashkët.

BE përballet me një sfidë konstante, plotësimi i pritshmërive të qytetarëve të vet. Ndërkohë, pa politika me dy nivele nuk ka shpresë që t’u shërbejë njësor ekonomive të forta dhe atyre të dobëta të bllokut.

BE ka nevojë për një vizion të ri, një projekt të ri për të cilin njerëzit të ndiejnë pasion.

Dhe nga mund t’ia fillojnë më mirë, se sa në zgjedhjet e kësaj jave për parlamentin europian. CNN



**Por BE është larguar gjithashtu nga koncepti i vet fillestar, me radhët e veta të tejfryra prej një makinerie burokratike me qendër në Bruksel që, sipas kritikëve, po e mbyt industrinë dhe po detyron shtete anëtarë si Mbretëria e Bashkuar që të largohen.**



# HISTORIA

## Një vullkan me emrin Europë

GIUSEPPE GALASSO

---

**E**uropa e vitit 1914 u shndërrua shumë shpejt në legjendë, pasi më shumë se katër vite luftë kishin tronditur çdo aspekt të jetës së saj civile dhe morale. Po çfarë ishte ajo botë e luftës së parë, që më vonë u bë objekt i shumë rikthimesh nostalgjikë?

Realiteti i dimensioneve të saj materiale dhe morale ishte imponues. Pak vende europianë kishin në zotërim tre të katërtat e globit. Ushtritë dhe flotat e tyre ishin të frikshme dhe të fuqishme. Ekonomitë e vendeve më të zhvilluar ishin të tilla që nuk mund të kishin me kë të krahasoheshin, përveç se me SHBA. Londra dhe Parisi ishin kryeqytetet e financës botërore. Cilësia e jetës ishte superiore ndaj kontinenteve të tjerë. Kudo, ndonëse me ngadalësi, po afirmohej një regjim lirire.

Edhe më shumë mund të thuhet për kulturën, progresin shkencor dhe teknik, qendrat studimore. Atmosfera e përgjithshme ishte e frymëzuar nga një optimizëm i pakufishëm: ndoshta vetëm në kohën e Iluminizmit, në Shtatëqindën, fatet e njerëzimit ishin dukur po kaq “të mrekullueshëm dhe progresistë”. Kishte nga ata që, ashtu sikurse natyralisti i madh Ernst Haeckel (me romanin e shitur në 400 mijë kopje), mendonin se nga “shtatë

enigmat e mëdha të botës” gjashtë ishin zgjidhur tashmë, kështu që mbetej vetëm njëra për t’u zgjidhur. Edhe lufta konsiderohej një mundësi e padyshtimë e historisë, por gjithësesi kishte lindur ndërkohë një lëvizje pacifiste me shtrirje shumë të gjerë (një prej çmimeve të parë Nobel u dha që në fillim për Paqen, dhe në vitin 1907 iu dha italianit Ernesto Moneta).

Për të gjithë këto arsye, u fol për një Belle époque, përpara tragjedisë së luftës. E megjithatë, në këtë botë sigurish dhe optimizmash, shumë shtytje dhe ngacmime eksplicitë dhe implicitë shfaqeshin të ndryshëm apo në kundërvënje mes tyre. Duke filluar që nga vetë pozicioni i Europës në botë. SHBA dhe Japonia ishin tashmë fuqi ekonomike, politike dhe ushtarake të nivelit të lartë. Në zotërimet europiane kishin filluar lëvizjet politike dhe sociale për pavarësinë, që Europa i përballonte me vështirësi, pasi këto zhvilloheshin mbi ide tërësisht europiane.

Megjithatë, më të rëndë ishin problemet e brendshëm, si ai nacional dhe ai social. Megjithëse aspiratat nacionale ishin kënaqur tashmë në shumë vende, të shumtë ishin popujt për të cilët kjo nuk kishte ndodhur. Ndodhte kështu në Irlandë, mes çekëve dhe italianëve të Austro-Hungarisë, mes polakëve të Austrisë, Gjermanisë e mbi të gjitha Rusisë. Në ndonjë rast bëhej fjalë edhe për hakmarrje të hapura, si për shembull mes Francës dhe Gjermanisë për luftën e 1870-71, që kushtoi humbjen e Alsasës dhe Lorenës. Po kështu, kombet e Ballkanit ishin në një rrëmujë të paqeverisëshme. Mes viteve 1911 dhe 1913 kishin luftuar në luftëra të ndërlikuara me Turqinë dhe të gjithë ndiheshin të keqtrajtuar nga marrëveshjet e mëvonshme të paqes. Prandaj nuk ishte rastësi që pikërisht në Ballkan ndodhi atentati që shkaktoi luftën e madhe.

Vetëdija e këtyre tensioneve themelorë nxiste një garë konstante për armatim në të gjithë fuqitë e mëdha dhe të vogla, si për shembull mes Gjermanisë dhe Anglisë në dete. Të forta ishin edhe rivalitetet për kolonitë. Vetëm në fund u shmangën konflikte mes Francës dhe Anglisë në 1898 dhe mes Gjermanisë dhe Francës në 1907. Por militarizmi dhe luftëdashja ishin më të fortë se sa pacifizmi, dhe mund të mbështeteshin në krenaritë dhe interesat kombëtarë me rrënjë të thella. Kundër rrezikut të luftërave në kushte disavantazhi, dhe për shkak të shqetësimeve të ekuilibrit dhe maturisë politike, kishin lindur dy sisteme aleancash: treshja Gjermani, Itali dhe Austro-Hungari dhe dyshja Francë-Rusi. Në momentin e të vërtetës u pa që ishin zinxhirë kushtëzues që e bënë luftën edhe më të pashmangshme, dhe të tillë që të tërhiqnin në konflikt edhe Anglinë, e vetmja fuqi e madhe europiane që nuk ishte pjesë e asnjë aleance.

Për çështjen sociale, problemet ishin dhe më të mëdhenj. Revolucioni industrial ishte në kulmin e tij në shumë vende, apo vetëm në fillime në disa të tjerë, por të gjithë i vuanin pasojat globale. Po lindte ndërkohë një emigracion i madh sidomos drejt Amerikave. Punëtorë dhe fshatarë ishin në lëvizje të vazhdueshme. Edhe për shkak të ndikimit të ideologjive marksiste, ata ushqenin pakënaqësira dhe dëshira për përmbysje që e bënë luftën e klasave një element të fortë të panoramës sociale, që justifikohej prej kushteve të jetesës së masave, pavarësisht përparimeve të bërë mbi të gjitha tek vendet e përparuar.

Vetëm në këta vende kishin lindur më pas forma të largpamësisë sociale, ndërkohë që greva dhe sindikatat shumë ngadalë po shndërroheshin në një të drejtë. Kështu që, nga një anë ekzistonte frika e “rrufesë” së një revolucioni të madh social, nga ana tjetër binte hija e një reagimi të madh politiko-social.

Në kulturën europiane të gjithë këto pasqyroheshin në sjelljet, shqetësi-



*Duke lartësuar  
zotërinjtë  
Schulz,  
Verhofstadt dhe  
Juncker, siste-  
mi ka dështuar  
me durim për  
të prodhuar  
talentin më të  
mirë politik që  
mund të ofrojë  
Europa. Njerëz  
të brendshëm të  
Brukselit që kanë  
shumë pak për  
të humbur, janë  
favorizuar*



met, grindjet, gjëra krejt të kundërta me kushtet në dukje të lumtura të kësaj zone të botës. Flitej për luftëra të mundshme, por në Europë prej një shekulli nuk kishte patur më konflikte që të përfshinin të gjithë shtetet. Dhe pikërisht ky mbizotërim i përgjithshëm i paqes, ky rend, kjo qetësi, kjo gjendje e një “shëndeti të mirë” nxiste reagime të kundërt. Futurizmi italian ishte një dokument mbresëlënës. Gjithçka që ishte “normale” shfaqej e dhimbshme, një mediokritet “borgjez” i padurueshëm. Rroftë shpejtësia e marrë, rroftë lufta, rroftë gjithçka që të prishte disiplinën dhe kriteret e traditave shtypëse, rroftë impulsin e vullnetit për pushtet dhe kënaqësi.

Paralajmërohej, më shumë nga sa dukej, se një e keqe e fshehtë, një vullkan i fshehur kërcënonte atë botë që parapëlqente të ekspozonte fatet e saj të mrekullueshme. Në fakt, disa prej intelektualëve të mëdhenj europianë e paralajmëruan. Por ndoshta të gjithë këto paralajmërime mund t’i gjejmë në melankolinë e thellë që jehon në galopin e valles së Excelsior-it apo në valset e Straussit: melankolia për diçka të bukur dhe të ëmbël që po rrëshket dhe po merr fund. (Corriere della sera)

---





# Europa në një botë shumëpolare

**VOLKER PERTHES**

---

**N**jë aspekt i krizës së Ukrainës, që si Rusia ashtu edhe Perëndimi kanë nevojë ta kuptojnë, është se pjesa tjetër e botës duket relativisht e pashqetësuar në lidhje me të. Ndonëse Perëndimi, bashkë me Japoninë, mund ta shohin krizën si një sfidë ndaj rendit global, shumica e shteteve të tjerë nuk ndihen të rrezikuar prej aneksimit të Krimesë nga Rusia, apo projektet që Rusia mund të ketë gjetkë në Ukrainë. Shumëkush mendon se kjo krizë ka të bëjë më shumë me paaftësinë e Europës për të zgjidhur mosmarrëveshjet e veta rajonale – ndonëse një rezultat i suksesshëm do të rriste shumë influencën e Europës si një paqebërës në nivel global.

Me shpалosjen e krizës së Ukrainës, politikanët dhe komentatorët në Rusi folën për “fundin e epokës së pas Luftës së Ftohtë”, ndërkohë që zëvendës kryeministri rus, Dimitri Rogozin u duk se mirëpriti madje fillimin e një tjetër Luftë të Ftohtë. Mendime të tillë predikohen mbi idenë që konflikti mes Rusisë dhe Perëndimit do të përcaktojë sërish të gjithë sistemin ndërkombëtar, duke e rikthyer kështu Rusinë në statusin e dikurshëm të superfuqisë.

Kjo nuk do të ndodhë. Sic e demonstrojnë edhe reagimet e fuqive në zhvillim ndaj krizës së Ukrainës, politika botërore nuk përcaktohet më prej asaj që ndodh në Europë, qoftë edhe kur aty ka një konflikt të madh. Sistemi ndërkombëtar është bërë kaq shumëpolar, saqë shtetet europeane tashmë mund të zgjedhin të ndjekin interesat e tyre, në vend që të ndihen të detyruar të bëhen palë me Lindjen apo me Perëndimin.

Shumë pak udhëheqës botërorë e vënë në dyshim faktin që përdorimi i forcës nga Rusia për të kompromentuar integritetin territorial të Ukrainës, ndryshuar kufijtë e saj, dhe aneksuar krimenë, ishte shkelje e ligjeve ndërkombëtarë. Abstenimi i Kinës në votimet e njëpasnjëshëm të Këshillit të Sigurimit, sinjalizoi qartë pakënaqësinë e liderëve të saj me politikat e Kremlinit. Por pothuajse një e treta e anëtarëve të OKB dërguan një mesazh po kaq të fortë duke abstenuar, apo duke mos marrë pjesë fare në votimin e Ansamblesë së Përgjithshme ku dënoheshin veprimet e Rusisë.

Edhe qeveri miqësore ndaj Perëndimit – përfshirë Brazilin, Indinë, Afrikën e Jugut dhe Izraelin – nuk ishin të përgatitura të merrnin njërën apo tjetrën anë. Gazetari indian Indrani Bagchi i quajti këta abstenime si një formë të re mos-reshtimi.

Edhe cinizmi, si dhe fryma e kohës janë duke luajtur një rol. Raja Mohan, një strateg i njohur indian, vëren se Europa “nuk ka pushuar asnjëherë së dhëni leksione Azisë për virtutet e rajonalizmit”, por tani duket e paaftë të përballojë sfidat e veta rajonale të sigurisë.

Mesazhi nga ky mos-reshtim është i drejtpërdrejtë: Përse duhet të na bëhet vonë për një konflikt territorial në Europë, kur ju europianët nuk veproni vendosmërisht në palestine, Kashmir, apo në mosmarrëveshjet territoriale në jug dhe lindje të Detit të Kinës? Shumë prej këtyre qeverive po i bëjnë thirrje Perëndimit që të zbusë krizën, dhe sic thoshte një deklaratë e Ministrisë së Jashtme kineze, “të vetëpërmbahen dhe të mos përshkallëzojnë tensionet”.

Kjo është këshillë e mirë – dhe jo e ndryshme nga ajo cfarë europianët u thonë atyre në situata të ngjashme. Megjithatë, ndryshe nga rajonet e tjerë të botës, Europa, përfshirë Rusinë mund të jetë krenare për organizatat e saj rajonale të sigurisë, si OSCE. Europa ka nevojë vetëm t’i bëjë të funksionojnë.

OSCE, për shembull, do të forcohej shumë nëse duke përdorur gamën e gjerë të mekanizmave të vet diplomatikë (si diskutimet në tryeza të rrumbullakëta dhe mbështetjen për reformat kushtetuese), do të ia dilte mbanë në shuarjen e krizës së Ukrainës, e si pasojë fuqizimin e sigurisë së Europës. Duke bërë këtë, do të ofronte edhe një shembull të fuqishëm të rajonalizmit të institucionalizuar, që mund të shërbejë si model për zgjidhje konfliktesh edhe për shtetet e tjerë.

Në të kundërt, nëse Europa nuk do të jetë në gjendje të zgjidhë krizën e Ukrainës me diplomaci, influenca e saj globale, dhe ajo e Rusisë me siguri që do të bien. Rusia i ka kujtuar botës se është e mundur të luahet fortin me fqinjin, si dhe t’i rrëmbesh terriore duke përdorur forcë. Por në një sistem shumëpolar të globalizuar, vetëm kjo nuk mjafton për të mbledhur shtete të tjerë përreth një kauze të tillë. Dhe BE, si një tigër prej letre shumë i sfofistikuar, nuk do të ishte më tërheqëse.

Shtetet anëtarë të BE nuk kanë interes që të lënë kontinentin e tyre të bjerë sërish në nacionalizëm etnik dhe politikën e fuqive. Kështu që, kriza e Ukrainës është sfidë por edhe shans. Nëse Europa dëshiron të mbetet një

pol në një botë shumëpolare, ajo duhet të vërtetohet se mundet të ndjekë një politikë të përbashkët të jashtme dhe sigurisë, sidomos në kohëra krizash dhe konfliktesh.

Kjo nënkupton që Europa duhet të dalë nga kriza e Ukrainës me një angazhim më të fortë për mbrojtjen e përbashkët dhe planifikimin e përbashkët për raste emergjencash, si dhe një politikë energjetike të unifikuar që mund të garantojë pavarësinë prej naftës dhe gazit rus. Por Europa duhet të tregojë gjithashtu se mundet, dhe që do t'i mbrojë, parimet e sistemit ndërkombëtar të bazuar mbi rregulla.

Ruajtja dhe forcimi i kolonave të mbrojtjes së përbashkët të Europës nuk është detyrë e lehtë. Por organizata shumëpalëshe të sigurisë, si OSCE, nuk janë bërë për kohë jo të vështira. Qëllimi i tyre është të mbrojnë vendet anëtarë nga manipulimet dhe agresioni, dhe në një mënyrë që mund të sigurojë mbështetje globale. Në këtë kuptim, detyra kryesore e Europës tani është që të vërë në punë asetet e saj të konsiderueshëm strategjikë. / Project Syndicate/

*\* Volker Perthes Drejtor i "Stiftung Wissenschaft und Politik", Instituti gjerman për Çështje Nderkombetare të Sigurisë, me qendër në Berlin*

---



# Manifest për një Europë ndryshe

TONY BLAIR

---

**I**nterpretimi i rezultateve zgjedhorë, sidomos kur pjesëmarrja nuk është e lartë, është një punë me risk. Dhe në rastin e zgjedhjeve të fundit për Parlamentin Europian, rezultatet nuk ishin uniformë. Rezultati më spektakolar ishte në Itali, ku një parti pro reformave dhe pro Europës e udhëhequr nga Kryeministri Matteo Renzi fitoi më shumë se 40% të votave. Kristian demokratët e Kancelares Angela Merkel fituan në Gjermani dhe atje pati gjithashtu një votë të fortë pro social demokratëve. Në disa raste, votimi thjeshtë ndoqi linjat e politikës së brendshme.

Por fitoret e UKIP në Britaninë e Madhe dhe Frontit Nacional në Francë, si dhe suksesi i partive të shprehura kundër status quo-së në të gjithë kontinentin nuk mund të injorohen. Ata flasin për një ankth të thellë, mosbesim, dhe ftohje ndaj institucioneve dhe filozofisë së Europës.

Tani, Europa duhet ta mendojë me kujdes se ku dëshiron të shkojë prej këtu, si do të rilidhet me qytetarët e vet dhe shqetësimet e tyre, dhe si mund t'i realizojë më mirë idealet e saj në një botë që ndryshon. Vetëkënaqësia, e mbështetur mbi faktin që shumica proeuropiane është



ruajtur është e rrezikshme. Edhe mbështetësit më të flaktë të Europës mendojnë që duhet të ketë ndryshim.

Janë të shumtë faktorët që janë kombinuar për të rritur numrin dhe kompleksitetin e sfidave që ndesh Europa, bashkë me pasigurinë dhe paparashikueshmërinë në lidhje me aftësinë e Europës për t'i përballuar ato. Kemi patur ambicien e madhe të monedhës së përbashkët, me të metat e saj që në konceptim, apo agoninë e krizës financiare dhe pasojat e saj, si dhe lidhjen mes të dyjave në krizën e borxheve sovranë. Kemi patur si sfidë edhe zgjerimin e BE nga 15 në 28 shtete anëtarë brenda një dekadë – për më tepër, një dekadë që u shoqërua nga një ndryshim i shpejtë në teknologji, tregti e gjeopolitikë.

Brenda eurozonës, BE u shndërrua nga një faktor thjeshtë i rëndësishëm, në një faktor që përcakton haptaz, buxhetet e ardhshëm të shteteve dhe politikat e tyre ekonomike. Në të vërtetë, duke parë dhimbjen e shkaktuar nga shkurtimet e mëdhenj në shpenzime, pa patur fleksibilitetin e ndryshimit në normën e këmbimit të valutës, surpriza e vërtetë është që thirrja e protestës nuk ka qenë më e madhe. Edhe ata që janë jashtë eurozonës janë prekur thellë, teksa institucionet europianë janë bërë edhe më të dukshëm, edhe më të sulmuar.

Në një botë gjithnjë e më shumëpolare, ku GDP dhe popullsia do të jenë gjithnjë e më të ndërlidhura, arsyeja e ekzistencës së Europës është më e fortë se kurrë. Së bashku, popujt e Europës mund të ushtrojnë ndikim pozitiv. Të vetëm, me kalimin e kohës do të pësojnë rënie të rëndësishme relative. Rendi botëror i shekullit 21 do të jetë dramatikisht i ndryshëm nga ai i shekullit 20. Arsyeja e ekzistencës së Europës sot nuk është paqja: është fuqia!

Nëse duam të kuptojmë potencialin e Europës, dhe shmangim një tërheqje të Britanisë në skaje, ekuilibri mes BE dhe shteteve anëtarë do të duhet të rishikohet që nga parimet e parë, institucionet europianë duhet të ribëhen për t'i bërë realisht më llogaridhënës dhe më pranë atyre që qeverisin.

Është e kuptueshme që qeveritë e dobëta të shteteve që po luftojnë me problemet ekonomike – dhe të gjendura nën një tryzni të fortë për të dalë me sukses – nuk kanë dëshirë për momentin për një debat të tillë “me rrënjë e me degë”. Kështu që, ne na duhet të bëjmë dallimin mes veprimit kohëgjatë dhe atij të menjëhershëm. Sfidat e menjëhershme është të sigurojmë ndryshimin më të madh të mundshëm brenda kuadrit ekzistues të institucioneve dhe traktateve europianë. Realizimi i kësaj kërkon një qasje dhe një axhendë të re.

Qasja e re duhet të nisë me Këshillin European, i cili duhet të shpallë përgjegjësinë e tij për t'i dhënë drejtim Europës, duke parashtruar një platformë të qartë dhe bindëse ndryshimi, që lidhet me shqetësimet e qytetarëve europianë dhe transformon këndvështrimin e asaj që Europa mund të arrijë në mënyrë aktive. Këshilli duhet të shoqërojë ambiciet e politikave të BE me një seri propozimesh konkrete për t'i realizuar ato, dhe më pas t'i lërë detyra Komisionit të ardhshëm European, me terma specifike për zbatimin e platformës.

Parlamenti European duhet të debatojë masat e nevojshme dhe do të duhet të miratojë ligjet që nevojiten. Këtu, Këshilli dhe Komisioni duhet të punojnë në unison, duke përshtatur një metodë angazhimi me Parlamentin, që nuk i lë komisionerët e veçantë në “mes të katër rrugëve”, atëherë kur këta gjenden të sulmuar.



***Nëse duam të kuptojmë potencialin e Europës, dhe shmangim një tërheqje të Britanisë në skaje, ekuilibri mes BE dhe shteteve anëtarë do të duhet të rishikohet që nga parimet e parë, institucionet europianë duhet të ribëhen për t'i bërë realisht më llogaridhënës dhe më pranë atyre që qeverisin.***

Axhenda për reforma duhet të merret me çështje që shtetet anëtarë nuk janë në gjendje t'i zgjidhin vetë, sipas interesit të tyre. Brenda eurozonës, kjo nënkupton një marrëveshje eksplicite sipas të cilës, në këmbim të vijimit të reformave strukturore nga shtetet anëtarë, do të ketë më shumë fleksibilitet fiskal dhe veprime të politikës monetare për të lejuar një rritje më të madhe ekonomike dhe shmangur deflacionin.

"Shitja" e reformës tek secili shtet anëtar do të jetë më e lehtë, nëse do të bëhet pjesë e një ujdje të madhe, ku fitimi dhe dhimbja janë të ekuilibruar. Për BE si një e tërë, është i domosdoshëm progresi në konsolidimin e tregut të përbashkët, sidomos në sektorin e shërbimeve. Dhe politikëbërësit duhet të bëjnë një shtytje të madhe për firmosjen e Partneritetit Transatlantik për Tregtinë dhe Investimet. Po kështu, në këtë axhendë për ndryshimin duhet të përfshihen idetë më të mira që lidhen me infrastrukturën dhe një program europian punësimi. Përpjekjet në këta fronte duhen bërë duke treguar se si vendet e punës dhe industria e të ardhmes mund të krijohen përmes një aksioni europian të bashkërenduar.

Po kështu, tani politika energjetike ka një rëndësi jetike, jo vetëm për konkureshmërinë e Europës, por edhe si rezultat i ngjarjeve në Europën Lindore dhe Ukrainë. BE nuk ka ndjekur asnjëherë një politikë të përbashkët energjetike me forcën që nevojitet. Impakti i kësaj do të ishte transformues. Një politikë e përbashkët energjetike dhe tregjet e integruar energjetikë do të sillnin dobi për biznese dhe konsumatorë, si dhe do të ulnin varësinë e Europës nga furnizuesit e huaj.

Së fundi, nëse Europa dëshiron të ushtrojë një fuqi që shkon në përpjestim me peshën e saj ekonomike, ajo duhet të ketë kapacitetin që të luajë rolin e saj në operacionet ushtarakë dhe në rolin thelbësor të ndërtimit të sektorit të sigurisë për partnerë potencialë që dalin nga trazira apo konflikte. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me shpenzimet. Ka të bëjë me sinergjitë. Përvojat e fundit në Afrikën Veriore dhe Afrikën Nën-Sahariane tregojnë se si mund të përdoret ky kapacitet.

Dua të jem i qartë për këtë axhendë reformash për Europën. Nuk e kam fjalën për konkluzionet normale të Këshillit që bashkohen në minutën e fundit të një mbledhjeje rutinë. E kam fjalën për një program preciz – quajeni një manifest për ndryshimin – që i tregon Komisionit ekzaktësisht çfarë duhet të bëjë dhe i jep Komisionit mbështetjen që i nevojitet për ta zbatuar.

**Dua të jem i qartë për këtë axhendë reformash për Europën. Nuk e kam fjalën për konkluzionet normale të Këshillit që bashkohen në minutën e fundit të një mbledhjeje rutinë. E kam fjalën për një program preciz – quajeni një manifest për ndryshimin – që i tregon Komisionit ekzaktësisht çfarë duhet të bëjë dhe i jep Komisionit**



# Edhe Dante donte një Europë të bashkuar

GIOVANNI VIGO

Uniteti europian si projekt politik ka lindur gjatë Nëntëqindës, në vijim të katastrofave që shkaktuan dy luftërat botërore, të cilat shumë historianë i kanë konsideruar “një luftë civile europiane”. Por, ideja e Europës ka një histori shumë më të gjatë. Në një libër të titulluar jo pa domethënie, “Vingthuit siecles d’Europe”, Denis de Reugemont ka hedhur një numër mbresëlënës dëshmish, që nga Hesiodi e deri tek mesi i Nëntëqindës, për të demonstruar që “Europa është shumë më e lashtë se sa kombet që e përbëjnë, por rrezikon që të zhduket për faj të mosmarrëveshjeve të tyre si dhe iluzionit për të ruajtur sovranitetin absolut. Në të kundërt, unioni i tyre do të ruante Europën, duke shpëtuar në të njëjtën kohë, atë që mbetet vitale në diversitetin e saj të frutshëm”.

Historianët kanë gjithmonë tundimin që të vihen në kërkim të pararendësve, edhe pse këta, qofshin ide apo persona, shfaqen zakonisht pas faktit të kryer. Është një fatalitet, sepse ndërkohë që historia ndodh, askush nuk e di rezultatit përfundimtar dhe vetëm koha përzgjedh atë që ka qenë e rëndësishme dhe atë që nuk ka patur peshë. Por deri kur duhet të hidhemi pas në kohë, për të gjetur fillesat e Europës? Tek miti i Europës, nimfa e bukur që u josh prej Jupiterit? Tek Tucididi, që shkruan: “Kur medët ishin larguar nga Europa, të mposhtur prej grekëve në tokë dhe në det...”? Apo tek Aristoteli, i cili e klasifikon me saktësi natyrën e euro-

pianëve, sipas vendit ku jetojnë, në Veri, në Jug apo në zonën e mesit të Kontinentit të Vjetër?

Në fillim ishte një ide e pasigurtë. Të zgjatesh me fjalë apo copëza frazash aty-këtu nëpër tekstet e lashtë mund të jetë corientuese, sepse nuk kuptohet me saktësi çfarë ka patur në mendje autori. Në vitin 767, duke përshkruar betejën e Poitiers, Isidori i Riu fliste për ushtrinë e Carlo Martellos si një ushtri “europianësh” (“Në mëngjes, duke dalë nga shtëpitë e tyre, europianët sulmuan cadrat e mirëreshtuara të arabëve”). Po sa ishte e gjallë mes ushtarëve dhe vetë kronistit vetëdija e të qënurit “europianë”? Duket më e mundshme që shkrimtari iberik e ka patur fjalën për një entitet gjeografik të papërcaktuar dhe që ushtarët nuk kanë dëgjuar asnjëherë të flitet për Europën.

Ndoshta ekzagjeron edhe Carlo Curcio kur saktëson: “Nëse me Europë nënkuptohet një njësi kulturore apo një njësi politike, mund të fiksohet origjina e saj në epokën Karolingiane, por, nëse me Europë nënkuptojmë një shumëllojshmëri harmonike popujsh që kanë vetëdijen e tyre, një “shoqëri kombesh”, atëherë origjina është shumë më vonë, mes shekujve XIII dhe XIV, në mos më vonë. Problemi më i rëndësishëm është që të përcaktohet nëse atëherë, ata kanë patur një ide të caktuar për Europën, nëse i kanë dhënë një emër, si në rastin e Charlemagne”.

Edhe pse Charlemagne ka qenë krijuesi i parë i “unionit monetar european” me futjen e lirës, të parave dhe monedhave – një sistem monetar, i destinuar të zgjaste për më shumë se një mijë vite – ajo dritëz bashkimi që ai kish mundur të realizonte u zhduk shumë shpejt me shpërbërjen e perandorisë. Përshtypja që krijohej, po të analizosh me saktësi shkrimet e juristëve, njerëzve të Kishës, këshilltarëve të oborreve, kronistëve që kanë jetuar në atë kohë, është që Europa ka qenë dicka e paqartë, që përgjithësisht ngatërrohej me Respublica Christiana, e cila përbënte lidhjen më të ndjerë mes njerëzve në atë kohë. Ajo nisi të përvijohet në fillimet e Treqindës, atëherë kur morën rrugë dy koncepte që sot do i quajmë “federalist” dhe “konfederalist”. Tek “Monarkia”, shkruar mes viteve 1310 dhe 1313, Dante Alighieri shpresonte për krijimin e një fuqie të fortë imperiale, në gjendje të limitonte sovranitetin e mbretërve të vecanta si dhe të nxiste bashkëpunimin e tyre paqësor. Perandoria universale përkonte me Europën dhe projekti i Dantes, ndonëse aty-këty me tipare utopistë, kishte një identitet të qartë politik. Këtij i kundërvijohet projekti, i hartuar disa vite më herët nga Pierre Dubois, një jurist i famshëm francez, që parashikonte krijimin e një Lidhjeje princërisht të pavarur nga Papa dhe nga perandori, që do të kishte një këshill dhe një ansamble përfaqësuese të “republikave më kristiane”.

Nuk është e vështirë të dallosh në këtë lidhje – në të cilën princërit ruanin sovranitetin e tyre të plotë, një projekt jo shumë të largët nga Europa e “mëmëdheve” aq e dashur për gjeneralin De Gaulle, dhe as Bashkimin European të sotëm në të cilin, përtej fasadës, sovranet e vërteta janë qeveritë. Historia europiane vazhdoi përgjatë rrugës së parashikuar nga Dubois, dhe nuk mund të ndodhte ndryshe, sepse nuk ekzistonin ende kushtet për bashkimin e popujve që mendonte Dante, ndërkohë që ishte më urgjente nevoja për të konsoliduar shtetin përreth një fuqie absolute, në gjendje të impononte autoritetin e saj, mbi një mijë feudet në të cilat ishin ndarë rajonet perëndimorë. Pasi u fuqizuan, Anglia, Franca, Spanja dhe Perandoria e Habsburgëve, u shndërruan në kolonat e atij që në fund të Shtatëqindës, Uilliam Robertson e quajti sistemi european i shteteve.

“Asnjë princ”, shkruante historiani anglez, “nuk ishte kaq u fuqishëm në krahasim me të tjerët, që sforcot e tij të ishin të parezistueshme,



*Edhe pse Charlemagne ka qenë krijuesi i parë i “unionit monetar european” me futjen e lirës, të parave dhe monedhave – një sistem monetar, i destinuar të zgjaste për më shumë se një mijë vite – ajo dritëz bashkimi që ai kish mundur të realizonte u zhduk shumë shpejt me shpërbërjen e perandorisë*





apo pushtimet të lehtë. Avantazhet që kishte një shtet, kundërbalan-coheshin prej rrethanave më të favorshme të të tjerëve, dhe kjo pengonte secilin prej tyre të arrinte një superioritet që do të kish rezultuar fatal për të gjithë. Kombet e Europës, atëherë ashtu si sot, ishin si një familje e madhe”. Një familje “jo e bashkuar dhe në grindje, pa dyshim”, shton Jean Baptiste Duroselle, “por një familje, gjithësesi. Po lindte një Europë e re, prej shteteve më të fuqishëm dhe koherentë”.

Në cdo sistem, pjesët e vecanta dhe e tëra janë të dallueshme qartë. Kështu, Luigji XIV mund të mendonte për madhështinë e Francës dhe të fliste, sic bënte shpesh, për “interesa” të Europës, për “paqe europiane”. Divergjencat dhe konfliktet që kanë shenjuar historinë në ata shekuj, nuk mund ta fshihnin idenë që europianët ishin të bashkuar prej një fati të përbashkët.

**Corriere della Sera**

~~~~~

**[www.asp.al](http://www.asp.al)**



**[www.bota.al](http://www.bota.al)**